**DOKUMENTI 14**

# RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI (TEMATIK)

## “NJËSIA ADMINISTRATIVE FARKË”

**Tiranë,2023**

**PËRMBAJTJA:**


| NR | EMËRTIMI I KAPITUJVE | FAQE |
|---|---|---|
| **I** | **PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE** | **3 - 6** |
| **1.** | Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit…………………… | **3 – 3** |
| **2.** | Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe Rekomandimeve……………… | **3 - 6** |
| **3.** | Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni I Auditimit………………… | **6 – 7** |
| **II** | **HYRJA** | **7 - 9** |
| | a. *Objektivat e auditimit.......................................................*<br>b. *Qëllimi i auditimit......................................................*<br>c. *Identifikim i cështjes..........................................................*<br>d. *Përgjegjësitë e strukturave drejtuese..........................................*<br>e. *Përgjegjësitë e Audituesve......................................................*<br>f. *Kriteret e vlerësimit ............................................................*<br>g. *Standardet e auditimit.........................................................*<br>h. *Metodat e auditimi ........................................................*<br>i. *Dokumenti i auditimit..........................................................* | |
| **III.** | **PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.** | **9 – 31** |
| **1.** | **Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim........................** | **9 – 9** |
| **2.** | **Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të audimit...............................** | **9 - 31** |

| | | |
|---|---|---|
| *2.1* | *Mbi verifikimin e procedurave të ndjekura për verifikimin e saktësisë së lëshimit të AMTP-ve, dhe konfirmimin e saktësisë të AMTP-ve dhe pozicionimit të planvendosjeve të tyre, për regjistrimin në ASHK......* | *9 – 31* |
| **IV.** | **GJETJE DHE REKOMANDIMI..................................................................** | **31 - 34** |


# I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

## I.1-Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e vijim* KLSH), në periudhën nga data 22.9.2022 deri në datën 30.3.2023 realizoi auditimin mbi përputhshmërinë (tematik)në subjektit Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë, sipas programit të auditimit nr. 796/1, datë 4.10.2022 (me ndryshime)të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit për periudhën nga data 01.01.2019 deri me datë 30.8.2022.

Auditimi u krye me zgjedhje për sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat realizohet veprimtaria, (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), janë konstatuar mangësi dhe parregullsi, më lidhje meverifikimin e procedurave të ndjekura për saktësinë e lëshimit të AMTP-ve dhe konfirmimi dhe pozicionimi i planvendosjeve të tyre për regjistrim të AMTP në Drejtoria Vendore ASHK Tirana Rurale.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione se në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga subjekti (me zgjedhje), për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë gjithë procedurës së këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit mbi Përputhshmërinë, Rregullorja funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Gjetjet e këtij auditimi janë të karakterit organizativ, të cilat i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, si dhe për të evidentuar përgjegjësitë nëpërmjet rekomandimit të masave disiplinore.

Raporti Përfundimtar i Auditimit është i strukturuar në katër kapituj: përmbledhja ekzekutive; hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të Audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj.; përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej 5 drejtimeve të auditimit; në kapitullin e katërt jepen gjetjet dhe rekomandimet dhe në fund janë anekset.

### I.2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe Rekomandimeve

| Gjetja Nr. | Përmbledhje e gjetjes | Rëndësia | Referenca me Raportin | Rekomandimi |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Në 3 raste** nga Administratori i Njësisë Administrative Farkë është dërguar AMTP-së "Dublikatë" nëpërmjet Sektorit të AMTP-së pranë Bashkisë Tiranë, *konkretisht*:<br>- Dokumentacionit i përcjell në emër të z. F. B, AMTP-ja (Dublikatë) është plotësuar duke u mbështetur në AMTP pa nr. Akti dhe pa datë nga ish-komisioni i fshatit Lundër.<br>- Dokumentacionit i përcjell në emër të z. P. A, AMTP-ja (Dublikatë) është plotësuar duke u mbështetur në AMTP pa nr. Akti dhe pa datë nga ish-komisioni fshatit Lundër.<br>- Dokumentacionit i përcjell në emër të z. Z. A, AMTP-ja (Dublikatë) është plotësuar duke u mbështetur në AMTP pa nr. Akti dhe pa datë nga ish-komisioni fshatit Lundër, në kundërshtim me piken 21.2 VKM nr.1174, datë 24.12.2020 "Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyes". | *I lartë* | *9-31* | Në gjitha rastet për kryerjen e procedurave që lidhen me krijimin e titujve të pronësisë të rinjë mbi tokën bujqësore, kur AMTP-ja do të plotësohet "Dublikatë", Njësia Administrative Farkë duhet të dërgoj AMTP-në për verifikim dhe miratim në Sektorin e AMTP-së pranë Bashkisë Tiranë. |
| 2 | **Në 3 raste** nga Njësia Administrative farkë është përcjellë për në DV ASHK Tirana Rurale 1, plani i rilevimit i hartuar nga eksperti gjeodet i licencuar, nuk përmbushë standardet teknike të përcaktuara në aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në RSH. | *I mesëm* | *9-31* | Njësia Administrative Farkë të përcjellë për në DV ASHK Tirana Rurale 1, plan rilevimit të hartuar nga eksperti gjeodet i licencuar, duke përmbushur standardet teknike të përcaktuara dhe në modelet e akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale. |

| Gjetja Nr. | Përmbledhje e gjetjes | Rëndësia | Referenca me Raportin | Rekomandimi |
|---|---|---|---|---|
| 3 | **Në 3 raste**, nga ish-komisioni i ndarjes së tokës në fshatë janë pajisur familjet bujqësore me tokë bujqësore më shumë se sa është përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Komunës duke tejkaluar normën për frymë, në kundërshtim me ish-ligjin nr, 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën" dhe me ligjit 20/2020 dhe ligjin nr.111/2018 "Për Kadastrën" | *I mesëm* | *9-31* | Nga Njësia Administrative Farkë në të gjitha raste para se të përcjellje dokumentacioni për në DV ASHK Rurale 1, të verifikojë normën për frymë, bazuar në certifikatën familjare datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992. |
| 4 | Nga Njësia Administrative Farkë është pranuar kërkesa për vazhdimin e procedurës së regjistrimit të pronës të trashëgimtarëve të familjes Kodra pa pasur një prokurë të posaçëm të trashëgimtarëve ligjorë për z. A. Ç, në lidhje me veprimet ligjore që do të kryen në Njësia Administrative Farkë dhe në ZVRPP Tiranë, çfarë do të thotë se personi nuk është i legjitimuar për paraqitjen e kërkesë për vazhdimin e procedurës së regjistrimit të pronës . | *I mesëm* | *9-31* | Nga Njësia Administrative Farkë mos të pranojë kërkesa për vazhdimin e procedurës së regjistrimit të pronës jashtë rrethit familjar të përfituesit të tokës bujqësore ose pa pasur një prokurë të posaçëm të trashëgimtarët ligjor. |
| 5 | Sipërfaqja e përfituar me AMTP prej 1900 $m^2$ si tokë bujqësore në llojin e pasurisë "arë" ndodhet brenda vijës së verdhë të qytetit, çfarë do të thotë se pasuria është tokë "truall" për rrjedhojë ish-komisioni i ndarjes së tokës fshati Shkozë ka vepruar në kundërshtim me VKM Nr. 452, date 17.10.1992 "Per ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore", në këto kushte qytetari nuk ka qenë i legjitimuar për të përfituar tokë sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore. | *I mesëm* | *9-31* | Nga Njësia Administrative Farkë në të gjitha rastet para se të përcjellje dokumentacioni për në DV ASHK Rurale 1, të verifikojë nëse kërkuesi ka qenë i legjitimuar për të përfituar tokë sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore. |
| 6 | **Në 5 raste**, nga specialisti ZAMIT-t të Njësisë Administrative Farkë nuk është verifikuar pasuria në terren, por është referuar plan-rilevimit i përgatitur nga topografi me licencë ku ky i fundit i është referuar pasurisë sipas hartës kadastrale të DV ASHK Rurale 1. | *I mesëm* | *9-31* | Specialisti i ZMMT-së, pranëNjësisë Administrative Farkë, në të gjitha rastet kur ka kërkesa nga saktësim harte duhet të verifikoj vetë fizikisht bashkë me topografin me licencë ndryshimet e ndodhura pa ndryshuar kufijtë e pronave të tjera. |

| Gjetja Nr. | Përmbledhje e gjetjes | Rëndësia | Referenca me Raportin | Rekomandimi |
|---|---|---|---|---|
| 7 | **Në 5 raste**, formulari i kërkesës që qytetari ka paraqitur pranë zyrës së informacionit të Njësisë Administrative Farkë, për vazhdimin e procedurës për regjistrim është plotësuar nga vetë specialisti i kësaj zyre. | *I mesëm* | *9-31* | Nëpunësi i zyrës së pritjes pranë Njësisë Administrative Farkë të pranoje kërkesa për vazhdimin e procedurës për regjistrim, të konfirmuar vetëm nga personi kërkues. |
| 8 | Nga ana e Njësisë Administrative Farkë është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në nr. 162 akti, viti 1996, për H. H, pa pasur më parë një deklaratë noteriale të shtetasit D. P në lidhje me pasurinë nr. 182/5 që figuron e regjistruar në vol.1, faqe 139 Z.K. 1605 në llojin e pasurisë “vreshtë” me sipërfaqe prej 2362 $m^2$ në emër të D. P, që krijon mbivendosje pasurie | *I mesëm* | *9-31* | Specialisti i ZMMT-së, pranëNjësisë Administrative Farkë, në të gjitha rastet kur ka kërkesa nga saktësim harte të shoqërohet më deklaratë noteriale me kufitarët e pasurisë që do të saktësohej. |
| 9 | **Në 5 raste**, pasuritë e përfituar me anë të AMTP-së bien mbi pasuri P.F. (tokë e pa frytshme”, mbi pasuri “rrugë” dhe mbi pasuri “pyll” . | *I mesëm* | *9-31* | Njësia Administrative Farkë para se të dërgoj AMTP-së dhe plan rilevimin për regjistrim, duhet që Specialisti i ZAMIT-së. të verifikoj formularin nr.6, librin e ngastrës dhe në hartën kadastrale të shkalles 1:5000 para vitit 1991, për vlefshmërinë e ngastrës për zërin kadastral të pasurisë. |
| 10 | Në të gjitha rastet, relacioni shpjegues i administruar në dosje i konspektuar nga specialisti ZMMT-së, i konfirmuar nga Përgjegjësi i Sektorit Shërbimeve Publike dhe i miratuar nga Administratori i Njësisë Administrative, janë pa datë miratimi dhe pa numër protokolli . | *I mesëm* | *9-31* | Specialisti i ZMMT-së, pranëNjësisë Administrative Farkë, në të gjitha rastet kur dokumentacioni shoqërohet me Relacion Shpjegues, kjo e fundit të protokollohet pranë zyrës së protokollit. |
| 11 | **Në 6 raste**, në dosje mungon e administruar vërtetimi për shlyerjen e pagesës së taksës së tokës bujqësore. | *I mesëm* | *9-31* | Administrative Farkëpara se të dërgoj AMTP-së, të kërkoje nga poseduesi i tokës bujqësore vërtetimi nga zyra e taksave dhe e tatimeve për shlyerjen e pagesës së taksës së tokës bujqësore. |

### I.2. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Ne e kemi kryer auditimin tonë në subjektin Njësia Administrative Farkë Bashkia Tiranë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin "*Përgjegjësitë e Audituesit*", pjesë e Raport Auditimit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 "*Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë*".

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë miratuar me Vendim nr. 66, datë 23.06.2020 edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 27, datë 20.04.2018, të Kryetarit të KLSH-së. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave me qëllim marrjen e evidencave të auditimit mbi ligjshmërinë. Procedurat janë përzgjedhur mbështetur mbi gjykimin profesional të audituesit.
Nga auditimi i përputhshmërinë, për sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat realizohet veprimtaria, (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), janë konstatuar mangësi dhe parregullsi, më lidhje meverifikimin e procedurave të ndjekura për saktësinë e lëshimit të AMTP-ve dhe konfirmimi dhe pozicionimi i planvendosjeve të tyre për regjistrim të AMTP në DV ASHK Tirana Rurale 1, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë *materiale por jo të përhapura*, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një *opinioni të kualifikuar,*paraqitura tek baza për opinion:

**Baza për opinionin**
Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Njësisë Administrative Farkë Bashkia Tiranë,me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat dhe rregulloret që lidhen me procedurat e regjistrimin të AMTP-ve,ku:
**-Në 3 raste** pasuritë e përfituar me anë të AMTP-së bie mbi pasuri "pyll", që do të thotë se nga Njësia Administrative Farkë, është pranuar kërkesa, për dërgimin e AMTP-së për regjistrim, pa shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore, (AMTP-së) pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative Farkë hartën e shk. 1:5000 dhe librin e ngastrës para vitit 1991.
**-Në 10 raste**, nga ish-komisioni i ndarjes së tokës në fshatë janë pajisur familjet bujqësore me tokë bujqësore për normë për frymë më shumë se sa është përcaktuar norma për frymë, bazuar në certifikatën familjare datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992.
**-Në 5 raste**, përfituesi i AMTP-së nuk ka qenë i legjitimuar për të përfituar tokë bujqësore sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore, bazuar në certifikatën e gjendjes familjare të administruar në dosje.
**-Në 6 raste**, plani i rilevimit i hartuar nga eksperti gjeodet i licencuar, nuk përmbushë standardet teknike të përcaktuara në aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në RSH".
**-Në 4 raste**, nga ana e specialistit të ZAMIT-t të Njësisë Administrative Farkë nuk është verifikuar pasuria në terren por është referuar plan-rilevimit i përgatitur nga topografi me licencë, ku ky i fundit i është nuk ka saktësuar pasurisë sipas terrenit, por është referuar hartës kadastrale të DV ASHK Rurale 1.
**-Në 1 rast**, është plotësuar AMTP "Dublikatë" nga Njësia Administrative Farkë dhe e dërguar direk për regjistrim pa u miratuar më parë nga Sektori i AMTP-së pranë Bashkisë Tiranë.
**-Në të gjitha rastet**, në dosje mungon e administruar vërtetimi për shlyerjen e pagesës së taksës së tokës bujqësore.

**Përgjegjësitë e Drejtuesve të Njësisë Administrative Farkë*:***
Strukturat drejtuese të Njësisë Administrative Farkë, janë përgjegjëse për konfirmimin e AMTP-ve dhe konfirmimin dhe miratimin e plan rilevimit për regjistrimin në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore të fushës, si dhe kryerjen e shërbimeve ndaj publikut brenda afateve ligjore, me qëllim rritjen e besueshmërisë dhe transparencës ndaj qytetarëve. Stafi drejtues është përgjegjës për drejtimin e institucionit, në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

**Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH*:***
Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse procedurat e konfirmimit të AMTP-ve dhe konfirmimin dhe miratim e plan rilevimit për regjistrimin të miratuara nga Njësisë Administrative Farkë, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse regjistrimi i pasurive dhe transaksionet mbi pasuritë, e regjistruara janë kryer, në përputhje me kriteret e përcaktuara dhe kërkesat ligjore. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese. Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e aktivitetit të institucionit gjatë të periudhës objekt auditimi, duke i përshkruar në raportin e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor, nuk lejon vënien në dispozicion të tyre, për p**u**blikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

## II. HYRJA

### 1. Përshkrim i auditimit.

Mbështetur në ligjin nr.154/14, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të Projektit dhe Programit Tematik të Auditimit nr. 796/1, datë 4.10.2022 (me ndryshime) të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, me afat auditimi nga data 22.9.2022 deri në datën 30.3.2023,në subjektin Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë u krye auditimi "Mbi verifikimin e procedurave të ndjekura për saktësisë së lëshimit të AMTP-ve dhe konfirmimin e saktësisë të AMTP-ve dhe pozicionimit të planvendosjeve të tyre, për regjistrimin në ASHK", për periudhën nga 01.01.2019 deri me datë 30.8.2022, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

*1.* **K. GJ** *Përgjegjës Grupi***.**
*2.* **S. S**
*3.* **P. GJ**

**a- Objektivat dhe qëllimi:**
***Objektivat***: Mbi dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për verifikimin e procedurave të ndjekura për verifikimin e saktësisë së lëshimit të AMTP-ve, dhe konfirmimin e saktësisë të AMTP-ve dhe pozicionimit të planvendosjeve të tyre, për regjistrimin në ASHK.

***Qëllimi***:Raportimi dhe evidentimi i gjetjeve, nxjerrja e konkluzioneve mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

**b- Identifikimi i çështjes:** Ky Raport Përfundimtar Auditimi, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të Njësisë Administrative Farkë, Bashkia Tiranë dhe përgjegjësive të tyre, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, përsa i përket procedurës së ndjekur për verifikimin e procedurave të ndjekura për e saktësisë së lëshimit të AMTP-ve, dhe konfirmimin e saktësisë të AMTP-ve dhe pozicionimit të planvendosjeve të tyre, për regjistrimin në ASHK. Në bazë të gjykimit dhe skepticizmit profesional, për qëllimet e auditimit, audituesit kanë bërë vlerësimin, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe janë vlerësuar evidencat e grumbulluara përsa i përket besueshmërisë, mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë.
Në lidhje me verifikimin e procedurave të mësipërme, nga Grupi i Auditimit u shqyrtuan dokumentacioni tekniko-ligjor, i AMTP-ve, formulari 6, libri kadastral i fshatrave, hartat kadastrale me shk: 1:5000 dhe si dhe harta me shkallë 1:2500, plan rilevimet deklarata noteriale, si dhe korrespondencat shkresore me institucionet përkatëse.

**c- Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar.**
Strukturat drejtuese dhe punonjësit e subjektit Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë janë autoriteti që konfirmojnë për çdo pasuri që gjendet në juridiksionin territorial. Për problematikat e trajtuara lidhur me çështjet nën auditim, të cilët mbajnë përgjegjësi për veprimet apo mosveprimet në lidhje me zbatimin e procedurës për verifikimin e procedurave të ndjekura për verifikimin e lëshimit të AMTP-ve, konfirmimin, saktësimin dhe pozicionimin planvendosjeve të tyre për regjistrimin në DV ASHK Rurale 1, në shkelje të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar dhe në referim të VKM nr. 994, datë 9.12.2015 "Për procedurën e regjistrimit të akteve të marrjes së tokës në pronësi".

**d- Përgjegjësitë e Audituesve.**
Përgjegjësia jonë është që të shprehim në lidhje me vlerësimin e verifikimin e procedurave të ndjekura për verifikimin e lëshimit të AMTP-ve, konfirmimin e saktësisë të AMTP-ve dhe pozicionimit të planvendosjeve të tyre, për regjistrimin në ASHK, bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e mbledhura. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryej auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

**e- Kriteret e vlerësimit.**
- Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", të ndryshuar.
- Ligji nr. 8312, datë 26.3.1998 "Për tokat bujqësore të pandara".
- Ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995, "Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore", të ndryshuar.
- Ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar.
- Ligjin nr. 171/2014, "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve".
- Ligji nr.20/2020, datë 5.3.2020 "Për përfundimin e procesit të kalimit në pronësi të përfituesve të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore".

- VKM nr. 994, datë 9.12.2015 “Për procedurën e regjistrimit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi (AMTP)”.

**f- Standardet e auditimit:**
Auditimi bazohet në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit nr.107, datë 08.08.2017, e ndryshuar nr. 63, datë 22.06.2020 dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI.

**i- Metodat e auditimit*:***
Përarritjen e objektivave, audituesit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit dhe në procedurat analitike. Metodat e përdorura gjatë auditimit në arritjen e konkluzioneve janë:
*-**Metoda "Testim hap pas hapi***: Përfaqëson veprime specifike që ndiqen brenda sistemit nga origjina deri në veprimin e fundit. Në këtë rast një numër i caktuar praktikash janë përzgjedhur për të parë se si njësia publike i është përmbajtur procedurave të caktuara.
*-**Metoda e ekzaminimit***: Kjo është një procedurë e cila ka shërbyer për të shqyrtuar të dhëna që lidhen me kryerjen e auditimit. Në këtë mënyrë, ajo që është vëzhguar dhe identifikuar të mund të testohet më tej. Vlerësimi ka përfshirë procedura testimi, si dhe gjykimin profesional të Audituesve në lidhje me përshtatshmërinë dhe efiçencën e veprimeve.
-***Metoda e ekzaminimit kryq***: Është përdorur kur është marrë informacioni për një ngjarje nga një burim i caktuar. Ky informacion është marrë dhe është krahasuar me një informacion të marrë për të njëjtat ngjarje, por me origjinë nga një burim tjetër. Kjo metodë është përdorur për të arritur nivelin e mjaftueshëm të besueshmërisë së përfundimeve**.**
-***Metoda e inspektimit fizik****:* Me anë të kësaj metode audituesit kanë verifikuar gjendjen fizike të dokumenteve të ndryshme në lidhje me çështjet nën auditim.
-***Metoda e intervistimit***: Është konsideruar si një nga metodat më të mira dhe më të përshtatshme të përdorura gjatë procesit të auditimit për të gjetur informacion të menjëhershëm. Duke qenë se kjo metodë kufizohet nga besueshmëria e evidencës së mbledhur gjatë përdorimit të saj, kjo metodë është përdorur për kontrollin dhe verifikimin e informacionit gjatë përdorimit të ekzaminimit kryq, ose forma të tjera si p.sh. caktimi i takimeve, intervistat me punonjësit e tjerë të institucionit, ballafaqimi midis punonjësve që kanë patur përgjegjësi në procesin e punës etj. Është intervistuar stafi menaxherial dhe operacional gjatë fazës së njohjes së aktiviteteve dhe proceseve të njësisë së audituar. Intervistat kanë ofruar një mundësi për parashtrimin e pyetjeve për sqarim të informacionit shtesë në bazë të përgjigjeve të dhëna. Audituesit kanë qenë të paanshëm dhe janë munduar të jenë sa më efektiv duke iu shmangur anshmërisë së informacioneve duke bërë pyetje të hapura (që kërkojnë përgjigje dhe shpjegime disi të gjera). Evidencat e auditimit që përftohet nga takimi janë mbajtur saktë dhe në mënyrë korrekte.
*-**Metoda e testimit të detajuar***: Audituesit kanë kryer ekzaminimin e dokumenteve të institucionit sipas objektivave të auditimit, dhe kanë marrë evidenca më të besueshme se sa intervistimi ose në mbështetje të informacioneve të mbledhura gjatë intervistimit.

**j. Dokumentimi i auditimit**
Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë dhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”. Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore. Konkluzionet janë arritur duke u bazuar në rezultatet e procedurave të kryera dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe në çështjet e rëndësishme që dolën gjatë auditimit.

Auditimi është në fazën ku nga subjekti audituar *(Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë)*, ka paraqitur kundërshtitë me shkresën nr. 858/3prot, datë 3,5,2023 *(prot KLSH nr. 796/15, date 8,5,2023)*mbi Projekt raport Auditimin, për të cilën grupi i KLSH pasi analizojë me kujdes, paanshmëri dhe profesionalizëm, mori në konaidetatë rastet të cilat kishin mbështetje ligjore dhe me dokumentacion. Ndërsa rastet e tjera të cilat nuk kishin argumentin e mjaftueshëm ligjorë gjejnë pasqyrim në këtë Raport Përfundimtar Auditimi (Tematik), i cili i përcillet subjektit për njohje dhe marrjen e masave për përmisimin e gjendjes në të ardhmen.

## III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

### 1. Informacioni i Përgjithshëm:

Nga të dhënat e paraqitur nga Njësia Administrative FarkëBashkia Tiranëpër konfirmimin e AMTP për regjistrim dhe procedurën e ndjekur për plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjorë dhe dërgimin e dosjeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJA-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, ku kjo e fundit pas verifikimit të mëtejshëm për dërgimin e tyre në ASHK Tiranë për regjistrim, në zbatim të urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 26474/1 datë 02.09.2016 "Për delegimin e kompetencave nga Bashkia Tiranë tek Njësitë Administrative nën administratimin territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë për kryerjen e procedurave që lidhen me krijimin e titujve të rinj të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe të procedurave që lidhen me shqyrtimin e vlefshmërisë tekniko-ligjore të titujve të pronësisë të krijuara, mbi tokën bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore dhe ish kooperativave bujqësore", i ndryshuar, në mbështetje në VKM-në nr. 994, datë 09.12.2015 "Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes të Tokës në Pronësi (AMTP), të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe ligji nr. 111/2018 "Për Kadastrën".

### 2. <u>Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të audimit</u>.

**Pika 2.1. Mbi verifikimin e procedurave të ndjekura për verifikimin e saktësisë së lëshimit të AMTP-ve, dhe konfirmimin e saktësisë të AMTP-ve dhe pozicionimit të planvendosjeve të tyre, për regjistrimin në ASHK.**

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezultoi se, Komuna Farkë sot Njësia Administrative Farkë, Bashkia Tiranë si pjesë e ish Ndërmarrjes Bujqësore ka ndarë tokë sipas ligjit nr. 7501 "Për Tokën" për familje të cilët kanë qenë banorë të ish NB me datë 17.07.1991 të dhënat në pasqyrën si më poshtë:

| Fshati | Sip. në dyny m | Nr Familjeve | | Numri i banorë ve 1991 | Norm a e tokës Për frymë (dyny | Sasi a e tokë s disp onib | Numri Familjeve të pajisur me tapi | Numri i familjeve pa tokë. |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Në 1991 | Të ardhur Pas 1991 | | | | | |

| | | | | | m) | ël | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| F. Madhe | 3560 | 400 | 133 | 1500 | 2.3 | - | 80 | 133 |
| F. Vogël | 3440 | 251 | 184 | 1100 | 3 | 40 | 105 | 184 |
| Lundër | 3100 | 270 | 42 | 1050 | 2.4 | - | 60 | 42 |
| Mjull-Batho | 4260 | 480 | 33 | 1900 | 2 | - | 150 | 33 |
| Sauk | 2240 | 480 | 28 | 1780 | 1.2 | - | 340 | 28 |
| Selitë | 200 | | | | - | | 10 | - |
| **Shuma** | **16800** | **1881** | **420** | **7330** | **2** | **40** | **745** | **420** |

*Burimi i të dhënave NJ/Administrative Farkë.*

Lidhur me normën për frymë me VKK nr. 16, datë 29.03.2013 ish- Këshilli i Komunës Farkë, ka miratuar në parim normën për frymë në ndarjen e tokës në fshatrat e ish-Komunës Farkë, dërguar në Drejtorisë së Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, Bashkia Tiranë me shkresën nr. 1581 prot, datë 02/05/2019, si më poshtë:

| N/R | Fshati | Norma e tokës Për frymë e miratuar (dynym) |
|---|---|---|
| 1 | F. Madhe | 3.5-4 |
| 2 | F. Vogël | 3.5-4 |
| 3 | Lundër | 3.5-4 |
| 4 | Mjull-Batho | 3.5-4 |
| 5 | Sauk | 3-3.5 |
| 6 | Selitë | 3-3.5 |

Nga të dhënat e paraqitur nga Njësia Administrative Farkë për konfirmimin e AMTP për regjistrim dhe procedurën e ndjekur për plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjorë dhe dërgimin e dosjeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJA-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, ku kjo e fundit pas verifikimit të mëtejshëm për dërgimin e tyre në ASHK Tiranë për regjistrim, kjo në zbatim të urdhrit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 26474/1 datë 02.09.2016 "Për delegimin e kompetencave nga Bashkia Tiranë tek Njësitë Administrative nën administratimin territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë për kryerjen e procedurave që lidhen me krijimin e titujve të rinj të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe të procedurave që lidhen me shqyrtimin e vlefshmërisë tekniko-ligjore të titujve të pronësisë të krijuara, mbi tokën bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore dhe ish kooperativave bujqësore" (i ndryshuar), në mbështetje në VKM-në nr. 994, datë 09.12.2015 "Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me Aktin e Marrjes të Tokës në Pronësi (AMTP), të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe ligji nr. 111/2018 "Për Kadastrën", *rezultoi si më poshtë*:

***Për vitin 2019,*** nga Njësia Administrative Farkë janë plotësuar dhe ka dërguar drejt Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë për **64 persona** të cilët kanë kërkuar për regjistrim të AMTP në ASHK të dhënat në pasqyrën si më poshtë:

| Nr. | Emri/Mbiemër | Protokolli | Datë | Tipologjia |
|---|---|---|---|---|
| 1 | A. S | 1043 | 15.03.2019 | Dergim Dok. Bashkia Tiranë |

| Nr. | Emri/Mbiemër | Protokolli | Datë | Tipologjia |
|---|---|---|---|---|
| 2 | A. X | 482/1 | 27.02.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| | A. X | 1837/2 | 29.07.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| | A. X | 482/4 | 24.04.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 3 | A. XH | 3856/1 | 27.12.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 4 | A. SH | 2125/1 | 26.06.2019 | Dërgim Dok. BashkiaTiranë |
| | A. SH | 2125/3 | 08.07.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 5 | B. XH | 1692/2 | 18.06.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 6 | B. C | 915/1 | 04.04.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 7 | B. P | 603 | 11.02.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 8 | B. T | 571/2 | 21.03.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| | B. T | 1710/3 | 05.06.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 9 | B. S | 1298/1 | 05.14.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 10 | B. S | 2552/5 | 18.12.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 11 | B. S | 406/2 | 06.02.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 12 | B. X | 218/3 | 30.09.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 13 | D. P | 602 | 11.02.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 14 | F. K | 1915 | 06.06.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| | F. K | 1915/2 | 15.07.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 15 | F. A | 3764 | 14.11.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 16 | F. XH | 180/1 | 12.04.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 17 | F. S | 1302/1 | 18.10.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 18 | H. B | 991/1 | 13.06.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 19 | H. H | 1057/1 | 27.03.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 20 | H. B | 02./03 | 27.12.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 21 | H. K | 99/2 | 26.06.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 22 | I. S | 1351 | 09.04.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 23 | I. P | 278/3 | 15.07.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 24 | L. H | 993/4 | 23.04.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 25 | L. H | 993/1 | 28.03.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 26 | M. S | 1301 | 05.04.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 27 | M. S | 1314/1 | 09.04.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 28 | M. D | 1832/1 | 17.10.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 29 | M. S | 356/2 | 05.03.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| | M. S | 1476/1 | 08.07.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia |

| Nr. | Emri/Mbiemër | Protokolli | Datë | Tipologjia |
|---|---|---|---|---|
| | | | | Tiranë |
| | M. S | 356/4 | 12.04.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 30 | M. C | 896/2 | 10.04.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 31 | N. B | 2817 | 11.09.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| | N. B | 2817/2 | 24.09.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| | N. B | 2817/4 | 08.10.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| | N. B | 3470/1 | 24.10.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 32 | P. M | 1359/1 | 26.04.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 33 | P. M | 4013/1 | 18.12.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 34 | Q. D | 249/2 | 05.02.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 35 | Q. GJ | 407/2 | 15.02.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 36 | Q. A | 1766 | 21.05.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 37 | Q. D | 536 | 05.02.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 38 | R. D | 1708/5 | 15.07.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| | R. D | 1708/3 | 26.06.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 39 | R. SH | 3637/1 | 26.11.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 40 | R. D | 1708/1 | 21.05.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 41 | R. S | 230/1 | 10.09.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 42 | R. Q | 2557/1 | 12.09.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 43 | R. B | 3677 | 05.11.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 44 | R. B | 1055/1 | 21.03.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 45 | S. B | 3645/1 | 04.11.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 46 | S. SH | 2370 | 23.09.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| | S. SH | 2970/2 | 05.11.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 47 | S. XH | 2091/1 | 30.09.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| | S. XH | 2091/3 | 13.11.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 48 | S. P | 789 | 25.02.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| | S. P | 789/2 | 02.04.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| | S. P | 1943 | 10.06.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 49 | S. H | 994/1 | 28.03.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 50 | S. D | 31./3 | 17.09.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 51 | S. S | 1046/1 | 19.03.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |

| Nr. | Emri/Mbiemër | Protokolli | Datë | Tipologjia |
|---|---|---|---|---|
| | S. S | 1046/3 | 03.05.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| | S. S | 1046/5 | 15.05.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 52 | S. P | 1982/1 | 27.06.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 53 | S. S | 717/1 | 09.04.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 55 | S. S | 717/5 | 05.06.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 55 | S. B | 178/1 | 06.02.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| | S. B | 178/3 | 15.07.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 56 | V. S | 3610/1 | 22.11.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| | V. S | 3610/3 | 26.12.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 57 | V. F | 910/1 | 09.04.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| | V. F | 910/4 | 30.05.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 58 | XH. L | 1311/5 | 10.09.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 59 | XH. SH | 443/2 | 05.03.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 60 | Y. S | 1393/1 | 16.04.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 61 | Z. B | 03./3 | 17.05.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 62 | Z. SH | 809/2 | 21.03.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| | Z. SH | 809 | 25.02.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 63 | Z. P | 1783/1 | 30.12.2019 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 64 | Z. XH | 566 | 07.02.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| | Z. XH | 566/3 | 02.04.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| | Z. XH | 1435 | 16.04.2019 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |

***Për vitin 2020***, nga Njësia Administrative Farkë janë plotësuar dhe ka dërguar drejt Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë për **25 persona** të cilët kanë kërkuar për regjistrim të AMTP në ASHK të dhënat në pasqyrën si më poshtë:

| | Emri/Mbiemër | Protokolli | Datë | Tipologjia |
|---|---|---|---|---|
| 1 | A. SH | 2951/1 | 05.11.2020 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 2 | B. H | 902/1 | 17.06.2020 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 3 | F. P | 1252 | 02.06.2020 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 4 | F. P | 548/3 | 18.06.2020 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 5 | G. B | 93/3 | 20.07.2020 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| | G. B | 93/5 | 12.08.2020 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |

| | Emri/Mbiemër | Protokolli | Datë | Tipologjia |
|---|---|---|---|---|
| 6 | H. P | 248/3 | 10.07.2020 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 7 | M. XH | 2368/1 | 06.10.2020 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 8 | M. XH | 1006 | 05.05.2020 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 9 | M. D | 2407/1 | 09.11.2020 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 10 | N. D | 3444 | 04.12.2020 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 11 | N. B | 1193/2 | 26.06.2020 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 12 | N. P | 1323/1 | 07.07.2020 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 13 | Q. D | 1971/3 | 12.11.2020 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| | Q. D | 1971/5 | 04.12.2020 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 14 | Q. D | 1397/4 | 14.10.2020 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 15 | R. SH | 3355/1 | 25.11.2020 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 16 | R. SH | 14./3 | 18.11.2020 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| | R. SH | 14./1 | 05.11.2020 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 17 | R. P | 2221/1 | 05.10.2020 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 18 | SH. P | 1763/3 | 12.11.2020 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| | SH. P | 1763/1 | 19.10.2020 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 19 | SH. B | 675/5 | 01.06.2020 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 20 | SH. S | 483/4 | 05.08.2020 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 21 | SH. G | 1499/1 | 09.07.2020 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| | SH. G | 1499/3 | 11.08.2020 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 22 | XH. B | 2798 | 28.10.2020 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| | XH. B | 2798/3 | 20.11.2020 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 23 | XH. S | 2905/1 | 05.11.2020 | Dërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 24 | Y. B | 985/5 | 06.07.2020 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| 25 | Z. B | 1327/1 | 26.06.2020 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |
| | Z. B | 1327/3 | 05.08.2020 | Ridërgim Dok. Bashkia Tiranë |

Për dosjet e plotësuara me dokumentacionin e nevojshëm tekniko ligjorë nga Njësia Administrative Farkë dhe të dërguara në Drejtorinë e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, kjo e fundit me shkresë ka bërë njoftim për **89 dosjet** e plotësuara të cilat janë nisur drejt ASHK për regjistrim, të dhënat në pasqyrën si më poshtë:

| Nr | Emër | Mbiemër | Nr. Prot | Date |
|---|---|---|---|---|
| 1 | A | H | 18627/1 | 24.05.2018 |

| Nr | Emër | Mbiemër | Nr. Prot | Date |
|---|---|---|---|---|
| 2 | A | B | 2424/5 | 21.05.2018 |
| 3 | S | M | 12892/1 | 02.05.2018 |
| 4 | R | P | 14734/3 | 02.05.2018 |
| 5 | R | P | 8266/1 | 12.03.2018 |
| 6 | G | SH | 8264/3 | 01.06.2018 |
| 7 | Q | D | 28244/1 | 28.09.2018 |
| 8 | S | D | 28241/1 | 28.09.2018 |
| 9 | SH | D | 28251/1 | 28.09.2018 |
| 10 | F | XH | 29955/2 | 21.09.2018 |
| 11 | F | D | 28242/1 | 28.09.2018 |
| 12 | K | B | 32752/1 | 28.09.2018 |
| 13 | M | D | 28248/1 | 28.09.2018 |
| 14 | S | D | 28249/1 | 28.09.2018 |
| 15 | A | D | 28250/1 | 28.09.2018 |
| 16 | M | D | 28246/1 | 28.09.2018 |
| 17 | N | SH | 4092/7 | 07.12.2018 |
| 18 | M | SH | 34528/4 | 03.12.2018 |
| 19 | B | D | 27904/1 | 05.11.2018 |
| 20 | A | S | 22418 | 05.11.2018 |
| 21 | SH | D | 27905/1 | 24.10.2018 |
| 22 | L | D | 15821/3 | 16.10.2018 |
| 23 | S | B | 21048/1 | 12.10.2018 |
| 24 | N | D | 31322/3 | 20.12.2018 |
| 25 | XH | XH | 6091/9 | 19.12.2018 |
| 26 | S | D | 28241/3 | 07.12.2018 |
| 27 | P | SH | 8750/1 | 15.03.2018 |
| 28 | M | SH | 30339/3 | 20.12.2018 |
| 29 | L | SH | 44617/1 | 31.12.2018 |
| 30 | SH | SH | 40602/3 | 31.12.2018 |
| 31 | H | H | 3869 | 23.01.2018 |
| 32 | M | G | 4778 | 28.01.2018 |
| 33 | G | SH | 30430/3 | 02.11.2018 |
| 34 | I | SH | 4783 | 29.01.2018 |
| 35 | J | M | 38197/5 | 28.12.2018 |
| 36 | D | P | 40099/1 | 29.12.2018 |
| 37 | B | P | 39053/3 | 29.12.2018 |
| 38 | V | SH | 40603/1 | 20.12.2018 |
| 39 | A | D | 4785 | 29.01.2018 |
| 40 | O | D | 4852 | 30.01.2018 |
| 41 | M | D | 28246/3 | 20.12.2018 |
| 42 | D | A | 42116/1 | 28.12.2017 |
| 43 | I | XH | 22539/1 | 04.10.2018 |
| 44 | M | XH | 17858/1 | 16.05.2018 |
| 45 | R | P | 4028 | 24.01.2018 |
| 46 | SH | SH | 24375/1 | 28.09.2018 |
| 47 | F | SH | 8265/3 | 30.05.2018 |
| 48 | Z | SH | 39054/3 | 20.12.2018 |
| 49 | XH | D | 28245/5 | 22.10.2018 |

| Nr | Emër | Mbiemër | Nr. Prot | Date |
|---|---|---|---|---|
| 50 | J | P | 2874/1 | 14.02.2018 |
| 51 | S | R | 2425/1 | 05.02.2018 |
| 52 | B | P | 2427/1 | 30.01.2018 |
| 53 | A | SH | 27214/3 | 27.10.2017 |
| 54 | D | SH | 22575/5 | 06.09.2017 |
| 55 | SH | P | 7829/5 | 27.04.2017 |
| 56 | H | D | 27903/1 | 16.10.2018 |
| 57 | A | K | 1986/3 | 28.02.2020 |
| 58 | F | A | 2681/3 | 28.02.2020 |
| 59 | A | D | 721/5 | 28.02.2020 |
| 60 | Z | P | 734/1 | 28.02.2020 |
| 61 | B | S | 6628 | 12.02.2020 |
| 62 | R | SH | 38829/3 | 23.11.2020 |
| 63 | Q | B | 14837/3 | 23.06.2020 |
| 64 | D | A | 21480/5 | 18.07.2029 |
| 65 | A | K | 34818/1 | 01.11.2019 |
| 66 | S | B | 1035/4 | 02.09.2019 |
| 67 | P | M | 4386 | 28.01.2019 |
| 68 | T | Q | 4853 | 30.01.2019 |
| 69 | N | A | 42377/1 | 27.12.2019 |
| 70 | B | P | 7727/5 | 27.06.2019 |
| 71 | A | SH | 26264/3 | 16.07.2019 |
| 72 | S | P | 69674/7 | 01.08.2019 |
| 73 | F | XH | 1172/6 | 31.07.2019 |
| 74 | M | S | 3902/9 | 16.07.2019 |
| 75 | S | H | 14074/5 | 05.06.2019 |
| 76 | Z | XH | 6806/8 | 21.05.2019 |
| 77 | L | H | 14075/5 | 29.05.2019 |
| 78 | A | D | 2572/1 | 26.02.2019 |
| 79 | Z | SH | 10068/3 | 06.05.2019 |
| 80 | B | Ç | 1570/4 | 06.05.2019 |
| 81 | M | K | 1122/1 | 14.01.2019 |
| 82 | SH | S | 21737/1 | 20.02.2019 |
| 83 | K | K | 1123./ | 19.02.2019 |
| 84 | Q | P | 2934/1 | 19.02.2019 |
| 85 | R | K | 1124/1 | 19.02.2019 |
| 86 | Q | D | 2864/3 | 18.03.2019 |
| 87 | XH | S | 5051/7 | 02.04.2019 |
| 88 | SH | D | 4021 | 24.01.2019 |
| 89 | S | D | 9450 | 26.02.2019 |

**Titulli gjetjes:***Problematikat e konstatuara në dërgimin e AMTP për regjistrim në ASHK.*

**Situata**

Nga të dhënat e rezulton se Njësia Administrative Farkë për periudhën objekt auditimi, ka dërguar AMTP për regjistrim drejt ASHK-së, duke mos qenë i legjitimuar për të përfituar tokë bujqësore, me si më poshtë:-

-**Në 3 raste**, nga Administratori i Njësisë Administrative

Farkë janë plotësuar AMTP "Dublikatë" mbas hyrjes në fuqi të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH".
**Në 3 raste,** plani i rilevimit i hartuar nga eksperti gjeodet i licencuar, nuk përmbushë standardet teknike të përcaktuara në aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në RSH".
**Në 3 raste,** nga ish-komisioni i ndarjes së tokës në fshatë janë pajisur familjet bujqësore me tokë bujqësore për normë për frymë më shumë se sa është përcaktuar norma për frym**ë**.
**Në të gjitha rastet**, plan-rilevimet e dërguara nga Njësia Administrative Farkë për regjistrim nuk janë të konfirmuara nga Administratori i A. T, por vetëm nga Kryeplaku i Fshatit dhe nga specialisti ZAMIT-t të Njësisë Administrative Farkë.
**Në të gjitha rastet**, relacioni shpjegues i administruar në dosje i konspektuar nga specialisti ZMMT-së, i konfirmuar nga Përgjegjësi i Sektorit Shërbimeve Publike dhe i miratuar nga Administratori i Njësisë Administrative, janë pa datë miratimi dhe pa numër protokolli.
**Në 5 raste**, nga specialisti ZAMIT-t të Njësisë Administrative Farkë nuk është verifikuar pasuria në terren, por është referuar plan-rilevimit i përgatitur nga topografi me licencë ku ky i fundit i është referuar pasurisë sipas hartës kadastrale të DV ASHK Rurale 1.
**Në 30 raste,** dosjet e kthyera për mangësi dhe mungesë të dokumentacionit të konstatuara nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, Drejtoria e Pasurive të Paluajtshme Bashkia Tiranë nuk janë plotësuar, por janë nisur përsëri më mangësi nga Njësia Administrative Farkë.
**Në 5 raste**, formulari i kërkesës që qytetari ka paraqitur pranë zyrës së informacionit të Njësisë Administrative Farkë, për vazhdimin e procedurës për regjistrim është plotësuar nga vetë specialisti i kësaj zyre.
**Në 3 raste**, nga ish-komisioni i tokës në fshatë nuk janë plotësuar aktet e marrjes të tokës në përdorim por direkt e në pronësi (AMTP).
**Në 5 raste**, pasuritë e përfituar me anë të AMTP-së bie mbi pasuri P.F. (tokë e pa frytshme", mbi pasuri "rrugë" dhe mbi pasuri "pyll".
**Në 4 raste,** plan-rilevimi nuk është e shoqëruar me deklaratë noteriale nga kufitarët .
**Në 6 raste,** në dosje mungon e administruar vërtetimi për shlyerjen e pagesës së taksës së tokës bujqësore

**Kriteri**

Në kundërshtim me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Tiranë nr. 26474/1, datë 02.07.2016 "Për delegimin e kompetencave nga Bashkia Tiranë tek Njësitë Administrative nën administrativin territorial dhe administrativ të Bashkisë Tiranë për kryerjen e procedurave

| | |
|---|---|
| | që lidhen me krijimin e titujve të rinj të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe të procedurave që lidhen me shqyrtimin e vlefshmërisë tekniko-ligjore të titujve të pronësisë të krijuara, mbi tokën bujqësore të ish ndërmarrjeve bujqësore dhe ish kooperativave bujqësore"; me VKM nr. 782, datë 7.10.2020 "Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale"; me ligjin nr. 7501, datë 19.7.1991, "Për tokën", i ndryshuar; ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995, "Për kalimin në pronësi, pa shpërblim, të tokës bujqësore", i ndryshuar; ligjin nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", i ndryshuar me ligjin nr. 171/2014, "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", i ndryshuar, si dhe Urdhrin nr. 39203/1, datë 17.10.2019 "Për një shtesë në Urdhrin nr, 26474/1, datë 02.09.2016 të Kryetarit të Bashkisë "Për delegim kompetencave nga Bashkia Tiranë tek Njësitë Administrative të Bashkisë Tiranë". |
| **Ndikimi/efektiviteti** | Parregullsia në dokumentacionin shoqërues të AMTP për regjistrim në kundërshtim me akte ligjore |
| **Shkaku** | Mos zbatimi i kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës. |
| **Rëndësia** | **I lartë** |
| **Për këtë rekomandojmë** | Njësia Administrative Farkë Bashkia Tiranë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të NJA-ve dhe Emergjencave Civile (DANJ-ve/AMTP-ve), Bashkia Tiranë, të mos përcjell AMTP-të për regjistrim, në Drejtorinë Vendore të ASHK Rurale 1, pa shqyrtuar vlefshmërinë tekniko-ligjore të titullit të pronësisë të krijuar mbi tokën bujqësore (AMTP-së), pa verifikuar dhe shqyrtuar dokumentacionin kadastral që disponon Njësia Administrative Farkë. |

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme sipas praktikave që kanë mbuluar, ngarkohen me përgjegjësi:**

1. **A. T** *me detyrë, Administrator i Njësisë Administrative Farkë.*
2. **F. T,** *me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së ZAMT*
3. **A. Q** *me detyrë, Përgjegjës Sektori i Shërbimeve Publike.*
4. **K. K** *me detyrë, Specialist i ZAMIT-së.*

**<u>Praktikat me parregullsi në dokumentacion</u>.**

**1. Praktika e kryefamiljarit z. S. H**

Me shkresën nr.994/1 prot., datë 28.03.2019 është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në pa nr.akti, datë 20.06.1995, për z. S. H, drejtuar Drejtorisë të Përgjithshme

Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, Drejtoria e Pasurive të Paluajtshme, Bashkia Tiranë, dokumentacioni si vijon:
1.Akti i marrjes së tokës në pronësi (fotokopje e njësuar).
2.Plan vendosja e pasurisë nr.51, 51/, 116/, 116/, shk.1:2500.
3.Çertifikatë e gjendjes civile të banori, datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992
4.Statusi juridik i pronës, nga ZVRPP Tiranë.
5.Relacion shpjegues.
6.Kërkesa e pronarit për regjistrim drejtuar Njësisë Administrative Farkë.
Familja bujqësore e përfaqësuar ngaz. S. H, ka përfituar tokë në pronësi me ligjin nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", bazuar ne AMTP pa nr.akti, datë 20.06.1995, gjithësej 29000 m$^2$, në 5 pasuri të ndryshme në llojin e pasurisë "arë", "pemëtore" dhe "ullishte", në fshatin Selitë.
Bazuar në statusin juridik të pronës të dërguar nga ZVRPP Tiranë me datë 07.03.2019 për tre pasuritë të përfituara me AMTP-në rezulton se pasuria 51/20 me sipërfaqe 12000 m$^2$ kartela është e hapur në vol. 8, faqe 216 me datë 12.021998, datë e cila ka mbaruar edhe afishimi publik po kështu edhe pasuria 51/20/1 me sipërfaqe 3000 m$^2$ dhe pasuria 116/14 me sipërfaqe 8000 m$^2$ janë të çelura në vol. 8, faqe 215 dhe në vol. 8, faqe 217, por që nuk janë trajtuar dhe pajisur me dokument pronësie, këto pasuri ndodhen ne Z.K. 3292.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit i përcjell në emër të S. H rezulton se çertifikata e gjendjes civile të përfituesit (kryefamiljarit) datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992, është me 2 (dy) anëtarë S. H dhe bashkëshortja F. H, ndërsa norma për frymë në Fshatin Selitë ka qenë 3-3.5 dynym tokë bujqësore, çfarë do të thotë se familja bujqësore e përfaqësuar ngaz. S. H ka përfituar 22000 m$^2$ më shumë se sa është përcaktuar norma për frymë në Fshatin Selitë, në këto kushte AMTP-ja pa nr.akti, datë 20.06.1995 është pjesërisht e pa vlefshme, në kundërshtim me ligjin nr.7501 datë 19.8.1991 "Për tokën", me VKM nr.255, datë 2.8.1991 "Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore" dhe me ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995, "Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore", të ndryshuar.
Shkresa nr.1193 prot., datë 26.05.2020 i dërguar për regjistrim prone bazuar në AMTP-në drejtuar Bashkisë Tiranë, është bazuar në ligjin 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin pasurive të paluajtshme" e shfuqizuar 2 vite më parë që me daljen e ligjit nr. 111/2018 "Për Kadastrën".
Referuar plan-rilevimet e hartuara nga subjekti privat i liçensuar në të cilën është pozicionuar pasuria 51/20 sipas gjendjes faktike, e pozicionuar në hartën kadastrale që punon DV ASHK Tirana Rurale 1, rezulton që pasuria 51/57, 62, 63 dhe 64, po kështu edhe pasuria 116/14 sipas planit të gjendjes faktike ka konfiguracion e pozicionim të ndryshëm nga paraqitja hartografike e bërë në hartën e punës dhe ky ndryshim konfiguracioni e pozicioni ka krijuar mbivendosje me pasuri të tretëve.
Gjithashtu nga verifikimi i planeve të rilevimit të administruara në dosje të përgatitur nga topografi me licencë datë 06.03.2019 dhe të miratuara vetëm nga Kryeplaku i Fshatit dhe nga specialisti ZAMIT-t të Njësisë Administrative Farkë, rezulton se pasuria 51/20 me sipërfaqe 12000 m$^2$ nuk përputhet me hartën kadastrale të ish-ZVRPP për faktin se kjo pasuri krijon mbivendosje me gjithë pasuritë 51/57, 62, 63 dhe 64, po kështu edhe pasuria 116/14 me sipërfaqe 4670 m$^2$ krijon mbivendosje me pasurinë 116/13 sipas hartës kadastrale të ish-ZVRPP.
Dokumentacioni i përcjellë nga Njësia Administrative Farkë në drejtim të Bashkisë Tiranë është rikthye disa herë nga kjo e fundit për mungesë dokumentacioni por që jane plotësuar dhe ridërguar përsëri nga Njësia Administrative Farkë.
Nga informacioni i marrë me shkresën nr.8257/1 prot., datë 14.11.2022 nga DV ASHK Rurale 1 rezulton se tre pasuritë e sipërcituara janë refuzuar për regjistrim për faktin se pasuritë krijon mbivendosje fiktive me pasuritë e tjera të regjistruara në emër të shtetasve të tjerë.

**<u>Konkluzion</u>:**

-Nga Njësia Administrative Farkëështë pranuar kërkesa për vazhdimin e procedurës së regjistrimit të pronës në emër të të z. S. H, bazuar në një AMTP ku rezulton se familja bujqësore ka përfituar një sipërfaqe prej 22000 m$^2$ tokën bujqësore më shumë se sa ka qenë norma për frymë në Fshatin Selitë.
-Nga Njësia Administrative Farkë është miratuar plan-rilevimi për 3 pasuri duke krijuar mbivendosje fiktive me pasuritë e tjera të regjistruara në emër të të tretëve.
-Në dosje nuk është e administruar deklarata noteriale e kufitarëve si dhe vërtetimi për shlyerjen e pagesës së taksës së tokës bujqësore.

**2. Me shkresën nr.1193 prot., datë 26.05.2020**është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-nëpa nr.akti, pa datë dhe pa vit, për **z. N. B,** drejtuar Drejtorisë të Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimi të NJA-VE dhe Emergjencave Civile, Drejtoria e Administrimit të NJA-VE dhe të AMTP-ve, Bashkia Tiranë, dokumentacioni si vijon:
1. Akti i marrjes së tokës në pronësi (fotokopje e njësuar).
2. Plan rilevimi i pasurisë nr.353/15, 353/18, 381/4, 381/23, 406/, shk.1:2500.
3. Çertifikatë e gjendjes civile të banorit, datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992
4. Statusi juridik i pronës ardhur nga DV ASHK Rurale 1+Qarku Tiranë.
5. Relacion shpjegues.
6. Deklarata noteriale e kufitarëve.
7. Vërtetim për shlyerjen e pagesës së taksës së tokës bujqësore.
8. Kërkesa e pronarit për regjistrim drejtuar Njësisë Administrative Farkë.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit i përcjell në emër të z. N. B rezulton se kjo familje bujqësore ka përfituar tokë në pronësi me ligjin nr.7501, datë 30/07/1991 "Për tokën", bazuar ne AMTP pa nr. Akti, pa datë dhe pa vit, emër të z. N. B gjithësej 11710 m$^2$ në 5 pasuri të ndryshme në llojin e pasurisë "arë", "pemëtore" dhe "ullishte", në fshatin Mjull-Bathore.
Referuar çertifikatës familjare, datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992 rezulton se janë 2 (dy) anëtarë, N. B dhe vëllai I. B, ndërsa norma për frymë në Fshatin Mjull-Bathore ka qenë 2 dynym tokë bujqësore, çfarë do të thotë se për këtë familje bujqësore e përfaqësuar ngaz. N. B është tejkaluar norma për frymë pasi sipas AMTP-së pa nr. Akti, pa datë dhe pa vit, emër të z. N. B, norma për frymë është 4000 m$^2$, në këto kushte AMTP-ja pa nr. Akti, pa datë dhe pa vit, është pjesërisht e pa vlefshme, plotësimi AMTP-së nga e ish-komisionit të ndarjes së tokës të fshatit Mjull-Bathore është në kundërshtim me ligjin nr.7501 datë 19.8.1991 "Për tokën", me VKM nr.255, datë 2.8.1991 "Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore" dhe me ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995, "Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore", të ndryshuar.
Shkresa nr.1193 prot., datë 26.05.2020 i dërguar për regjistrim prone bazuar në AMTP-në drejtuar Bashkisë Tiranë, është bazuar në ligjin 33/2012, datë 21.3.2012 "Për regjistrimin pasurive të paluajtshme" e shfuqizuar 2 vite më parë që me daljen e ligjit nr. 111/2018 "Për Kadastrën", që do të thotë se nga ana e punonjësve të Njësisë Administrative Farkë nuk janë të azhurnuar me ndryshimet ligjore.

**Konkluzion:**
-Është pranuar kërkesa nga Njësia Administrative Farkë për vazhdimin e procedurës së regjistrimit të pronës në emër të z. N. B, bazuar në një AMTP ku rezulton se ka përfituar një sipërfaqe prej 7710 m$^2$ tokën bujqësore më shumë se sa ka qenë norma për frymë në Fshatin Mjull-Bathore.

-Formulari i kërkesës me nr.1341 prot., datë 09.04.2019 drejtuar zyrës së informacionit të Njësisë Administrative Farkë, për vazhdimin e procedurës për regjistrim është plotësuar nga vetë specialisti i kësaj zyre K. F.
-Kjo praktikë është kthyer nga Bashkia Tiranë me shkresën nr.17105/3 prot., datë 03.09.2020, për plotësim dokumentacioni (mbivendosje pasuri dhe për tejkalim norme për frymë).

**3.Me shkresën nr.3620/1 prot., datë 15.11.2018** është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-nëpa nr. Akti, pa datë dhe pa vit, për **z. S. B,** drejtuar Drejtorisë të Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, Bashkia Tiranë, dokumentacioni si vijon:
1. Akti i marrjes së tokës në pronësi (fotokopje e njësuar).
2. Plan rilevimi i pasurisë nr.257/11/1, 257/14/1, 404/13, 404/15, shk. 1:2500 datë 10.05.2018.
3. Çertifikatë e gjendjes civile të banorit, datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992
4. Relacion shpjegues.
5. Deklarata noteriale e kufitarëve.
6. Statusi juridik i pronës ardhur nga ZVRPP Tiranë.
7. Vërtetim për shlyerjen e pagesës së taksës së tokës bujqësore.
8. Kërkesa e pronarit për regjistrim drejtuar Njësisë Administrative Farkë.
Shkresa e sipërcituar e Njësisë Administrative Farkë është kthyer dokumentacioni nga Bashkia Tiranë, për saktësim harte (plan-rilevimi),
Nga shqyrtimi i dokumentacionit i përcjell në emër të z. S. B të depozituar në Bashki, rezulton se pasuria me nr.257/11/1 me sipërfaqe 550 $m^2$ mbivendoset me parcelën me nr. 632, me zërin kadastral P.F edhe pasuria 257/14.1 me sipërfaqe 3550 $m^2$ mbivendoset me parcelën me nr.256, Z.K 2704, në Fshatin Mjull-Bathore.
Me shkresën nr.178/1 prot., datë 06.02.2019 është ridërguar dokumentacioni për regjistrim prone për z. S. B, drejtuar Drejtorisë të Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, Bashkia Tiranë, po me këto plan-rilevime të përgatitur nga topografi me licencë S. M datë 10.05.2018 ku nga verifikimi rezulton se të dyja këto plan-rilevime nuk përputhen me gjendjen faktike në terren, ky fakt provohet nga matjet në geoportalin ASIG, por edhe nga verifikimi i imazheve në Google Earth, çfarë do të thotë se janë miratuar plan-rilevimet nga Njësia Administrative Farkë pa i verifikuar gjendjen faktike të pasurisë.

**Konkluzion:**
-Janë miratuar nga Njësia Administrative Farkë dy plan-rilevime duke mos u përputhë me gjendjen faktike në terren.
-Është miratuar plan-rilevimi i miratuara nga Njësia Administrative Farkë për pasurinë me nr.257/11/1 me sipërfaqe 550 $m^2$ e përfituar me AMTP mbi pasurinë P.F.

**4.Me shkresën nr.3595/1 prot., datë 09.11.2018** është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-nëpa nr. Akti, pa datë dhe pa vit, për **z. Z. XH,** drejtuar Drejtorisë të Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, Bashkia Tiranë, dokumentacioni si vijon:
1. Akti i marrjes së tokës në pronësi (fotokopje e njësuar).
2. Plan rilevimi i pasurisë nr.125/, 241/2, 328/1, 376/, 381/16 shk. 1:2500, datë 10.09.2018.
3. Çertifikatë e gjendjes civile të banorit, datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992
4. Relacion shpjegues.
5. Deklarata noteriale e kufitarëve.
6. Statusi juridik i pronës ardhur nga ZVRPP Tiranë.
7. Kërkesa e pronarit për regjistrim drejtuar Njësisë Administrative Farkë.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit i përcjell në emër të z. Z. XH të depozituar në Bashki, rezulton se kjo dosje është përgatitur për regjistrim që në vitin 2013 dhe është kthyer për plotësim dokumentacioni tre herë nga Bashkia Tiranë.
Nga verifikimi i hartës kadastrale 1:5000 para vitit 1991 rezulton se parcela me nr. Rendor në AMTP me emrin “Topore” rezulton me nr 241 ndërsa me HTR shk. 1:2500 kjo pasuri ndodhet

me nr.328/1 ne zërin kadastarl “arë” me sipërfaqe 2000 $m^2$ kjo pasuri gjithashtu bie mbi pasurinë nr.608 të zërit kadastral P.F. kjo pasuri ndodhët në Z.K 3266, në Fshatin Sauk.

**Konkluzion:**
-Është miratuar nga Njësia Administrative Farkë plan-rilevimi për parcelën e renditur në AMTP me emrin “Topore” me sipërfaqe 2000 $m^2$ mbi pasurinë nr.608 të zërit kadastral P.F.
-Mungon e administruar në dosje vërtetimi për shlyerjen e pagesës së taksës së tokës bujqësore.

**5.Me shkresën nr.3470/1 prot., datë 24.10.2019** është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-nëme nr. Akti 115, datë 20.06.1996, për **z. N. B** drejtuar Drejtorisë të Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, Bashkia Tiranë, dokumentacioni si vijon:
1. Akti i marrjes së tokës në pronësi (fotokopje e njësuar).
2. Plan rilevimi i pasurisë nr.157/2, dhe 138/2 shk. 1:2500, datë 27.03.2017.
3. Çertifikatë e gjendjes civile të banorit, datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992
4. Relacion shpjegues.
5. Deklarata noteriale e kufitarëve.
6. Statusi juridik i pronës ardhur nga ZVRPP Tiranë.
8. Kërkesa e pronarit për regjistrim drejtuar Njësisë Administrative Farkë.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit i përcjell në emër të **N. B** rezulton se bazuar ne AMTP-nëme nr. Akti 115, datë 20.06.1996 familja Brari të ketë përfituar gjithësej 19000 $m^2$ tokë bujqësore, bazuar në çertifikatën e gjendjes civile të përfituesit (kryefamiljarit) datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992, rezulton së në përbërjen e certifikatës familjare janë me 3 (tre) anëtarë. Bazuar në shkresën nr 1581 prot., datë 02.05 2019 të Njësisë Administrative Farkë, është përcaktuar norma për frymë për çdo fshat ku për Fshatin Selitë norma për frymë është 3-3.5 dynym tokë bujqësore, ndërkohë që bazuar në dokumentacionin rezulton se z. N. B është furnizuar me tokë me 3800 $m^2$ për frymë, çfarë do të thotë se familja bujqësore e përfaqësuar ngaz. **N. B** ka përfituar 9000 $m^2$ më shumë se sa është përcaktuar norma për frymë në Fshatin Selitë, në këto kushte AMTP-nëme nr. Akti 115, datë 20.06.1996, është pjesërisht e pa vlefshme, plotësimi AMTP-së nga e ish-komisionit të ndarjes së tokës të fshatit Selitë është në kundërshtim me ligjin nr.7501 datë 19.8.1991 “Për tokën”, me VKM nr.255, datë 2.8.1991 “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore” dhe me ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995, “Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore”, të ndryshuar.

**Konkluzion:**
-Është pranuar kërkesa nga Njësia Administrative Farkë për vazhdimin e procedurës së regjistrimit të pronës në emër të z. N. B, bazuar në një AMTP ku rezulton se ka përfituar një sipërfaqe prej 9000 $m^2$ tokën bujqësore më shumë se sa ka qenë norma për frymë në Fshatin Selitë.
-Mungon deklarata noteriale ku z.B. dhe familja bujqësore të shprehet për heqjen dorë të 9000 $m^2$ që ti hapet rrugë për regjistrimin e pjesës tjetër të pasurisë.
-Në dosje mungon e administruar vërtetimi për shlyerjen e pagesës së taksës së tokës bujqësore.

**6.Me shkresën nr.1915/1 prot., datë 06.06.2019** është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-nëpa nr. Akti, pa datë dhe pa vit, për **F. K,** drejtuar Drejtorisë të Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, Bashkia Tiranë, dokumentacioni si vijon:
1. Akti i marrjes së tokës në pronësi origjinal.
2. Plan rilevimi i pasurisë nr. 664/ shk. 1:2500, datë 10.04.2019.
3. Çertifikatë e gjendjes civile të banorit, datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992
4. Relacion shpjegues.
5. Deklarata noteriale e kufitarëve.
6. Statusi juridik i pronës ardhur nga ZVRPP Tiranë.

7. Vërtetim për shlyerjen e pagesës së taksës së tokës bujqësore.
8. Dëshmia e trashëgimisë.
9. Kërkesa e pronarit me prokurë për regjistrim drejtuar Njësisë Administrative Farkë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit i përcjell në emër të z. **F. K** të depozituar në Bashki, bazuar në AMTP-nëpa nr. Akti, pa datë dhe pa vit, rezulton se shtetasi ka përfituar një sipërfaqe prej 7000 $m^2$ tokë bujqësore në llojin e pasurisë "vreshtë".

Nga verifikimi i plan-rilevimit i përgatitur më datë 10.04.2019 nga topografi me licencë S. M, rezulton se pasuria nr.664/ është me sipërfaqe 5200 $m^2$ dhe jo 7000 $m^2$ sa është në AMTP, për diferencën prej 1800 $m^2$ trashëgimtarët e z. F. K kanë bërë deklaratë noteriale datë 23.10.2021 që jemi dakort që të regjistrohet vetëm sipërfaqja prej 5200 $m^2$, për pjesën tjetër nuk deklarohen se heqim dorë.

Plan-rilevimit i përgatitur më datë 10.04.2019 nuk përputhet me kufitarët e paraqitura ne AMTP-në, për faktin se pasuria sipas plan-rilevimit kufizimi në veri-lindje është rrugë dhe jo persona privat siç është në AMTP, po kështu referuar statusit juridik të pronës e konfirmuar me shkresën nr.21669 prot., datë 10.07.2018 nga ZVRPP Tiranë, rezulton se pasuria nr. 664/24 figuron e regjistruar në vol.8, faqe 78 Z.K. 2529 në llojin e pasurisë "arë" me sipërfaqe prej 3750 $m^2$ në pronësi të B.D., mbi këtë pasuri është përgatitur edhe plan-rilevimi duke krijuar mbivendosje me hartën kadastrale të ZVRPP Tiranë.

Në dosje është administruar prokura e posaçme datë 15.02.2012 ku përfaqësuesit F. K dhe N. K., emërojnë si përfaqësues të posaçëm dhëndrin z. A. Ç për kryerjen e veprimeve në lidhje me veprimet ligjore që do të kryen në ZVRPP Tiranë dhe në Komunën Farkë.

Në dosje është administruar edhe vendimi i lëshimit të dëshmisë së trashëgimisë ligjore datë 07.05.2019 të trashëgimlënësit F. K, ku trashëgimtarët e radhës së parë janë bashkëshortja dhe 3 vajzat.

**<u>Konkluzion</u>:**
-Në dosje nuk është administruar deklarata noteriale B. D. për heqjen dorë mbi pasurinë 664/24 që figuron e regjistruar në vol.8, faqe 78 Z.K. 2529 në llojin e pasurisë "arë" me sipërfaqe prej 3750 $m^2$.
-Nga Njësia Administrative Farkë është pranuar kërkesa për vazhdimin e procedurës së regjistrimit të pronës të trashëgimtarëve të familjes Kodra pa pasur një prokurë të posaçëm të trashëgimtarëve ligjorë për z. A. Ç, në lidhje me veprimet ligjore që do të kryen në Njësia Administrative Farkë dhe në ZVRPP Tiranë, çfarë do të thotë se personi nuk është i legjitimuar për paraqitjen e kërkesë për vazhdimin e procedurës së regjistrimit të pronës.

**7.Me shkresën nr.2076/2 prot., datë 19.12.2017** është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-nëpa nr. Akti, pa datë dhe pa vit, për **B. S,** drejtuar Drejtorisë të Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, Bashkia Tiranë, dokumentacioni si vijon:
1. Akti i marrjes së tokës në pronësi.
2. Plan rilevimi i pasurisë nr. 10/67, 12/26, 12/32, 12/33 shk. 1:2500, datë 28.02.2019.
3. Çertifikatë e gjendjes civile të banorit, datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992
4. Relacion shpjegues.
5. Deklarata noteriale e kufitarëve.
6. Statusi juridik i pronës ardhur nga ZVRPP Tiranë.
7. Kërkesa e pronarit me prokurë për regjistrim drejtuar Njësisë Administrative Farkë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit i përcjell në emër të z. **B. S** të depozituar në Bashki, bazuar në AMTP-nëpa nr. Akti, pa datë dhe pa vit, rezulton se shtetasi ka përfituar një sipërfaqe prej 1900 $m^2$ tokë bujqësore në llojin e pasurisë "arë".

**<u>Konkluzion</u>:**
-Sipërfaqja e përfituar me AMTP prej 1900 $m^2$ si tokë bujqësore në llojin e pasurisë "arë" ndodhet brenda vijës së verdhë të qytetit, çfarë do të thotë se pasuria është tokë "truall" për rrjedhojë ish-komisioni i ndarjes së tokës fshati Shkozë ka vepruar në kundërshtim me VKM

Nr. 452, date 17.10.1992 “Per ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”, në këto kushte qytetari nuk ka qenë i legjitimuar për të përfituar tokë sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore.
-Plan rilevimi i pasurisë nr. 10/67, 12/26, 12/32, 12/33 shk. 1:2500, datë 28.02.2019 i përgatitur nga topografi me liçencë nuk është i konfirmuar nga Administratori i A. T dhe nga specialisti ZAMIT-t të Njësisë Administrative Farkë, ndonëse me shkresën nr.22581/1 datë 14.06.2017 të Bashkisë Tiranë i ka kaluar për kompetencë Njësisë Administrative për kryerjen e procedurave paraprake që lidhen me krijimin e titujve të rinjë të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe procedurën që lidhen me shqyrtimin e vlefshmërisë tekniko-ligjore.
-Në dosje mungon e administruar vërtetimi për shlyerjen e pagesës së taksës së tokës bujqësore.

**8.Me shkresën nr.1859/2 prot., datë 07.06.2019** është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në nr. 162 akti, viti 1996, për **H. H,** drejtuar Drejtorisë të Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, Bashkia Tiranë, dokumentacioni si vijon:
1. Akti i marrjes së tokës në pronësi.
2. Plan rilevimi i pasurisë nr. 182/5 shk. 1:2500, datë 15.07.2018.
3. Çertifikatë e gjendjes civile të banorit, datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992
4. Relacion shpjegues.
5. Deklarata noteriale e kufitarëve.
6. Statusi juridik i pronës ardhur nga ZVRPP Tiranë.
7. Kërkesa e pronarit me prokurë për regjistrim drejtuar Njësisë Administrative Farkë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit i përcjell në emër të z. **H. H** të depozituar në Bashki, bazuar në AMTP-në, rezulton se shtetasi ka përfituar një sipërfaqe totale prej 8000 m$^2$ tokë bujqësore në llojin e pasurisë “arë” dhe “vreshtë”.
Referuar statusit juridik të pronës e konfirmuar me shkresën nr.21670/1 prot., datë 08.08.2018 nga ZVRPP Tiranë, rezulton se pasuria nr. 182/5 figuron e regjistruar në vol.1, faqe 139 Z.K. 1605 në llojin e pasurisë “vreshtë” me sipërfaqe prej 2362 m$^2$ në emër të D. P (i pa pajisur me certifikatë pronësie), mbi këtë pasuri është përgatitur edhe plan-rilevimi duke krijuar mbivendosje me pasurinë e përfituar nga D. P.
Në dosje mungon e administruar deklarata noteriale shtetasit D. P në lidhje me pasurinë nr. 182/5 që figuron e regjistruar në vol.1, faqe 139 Z.K. 1605 në llojin e pasurisë “vreshtë” me sipërfaqe prej 2362 m$^2$ në emër të D. P.

**<u>Konkluzion</u>:**
-Nga ana e Njësisë Administrative Farkë është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në nr. 162 akti, viti 1996, për H. H, pa pasur më parë një deklaratë noteriale të shtetasit D. P në lidhje me pasurinë nr. 182/5 që figuron e regjistruar në vol.1, faqe 139 Z.K. 1605 në llojin e pasurisë “vreshtë” me sipërfaqe prej 2362 m$^2$ në emër të D. P, që krijon mbivendosje pasurie.
-Në dosje mungon e administruar vërtetimi për shlyerjen e pagesës së taksës së tokës bujqësore.

**9.Me shkresën nr.3610/1 prot., datë 22.11.2019** është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në pa nr. Akti, pa datë dhe pa vit, për z. **V. SH,** drejtuar Drejtorisë të Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, Bashkia Tiranë, dokumentacioni si vijon:
1. Akti i marrjes së tokës në pronësi.
2. Plan rilevimi i pasurisë nr. 541/, 485/, 508, shk. 1:2500, datë 21.06.2018.
3. Çertifikatë e gjendjes civile të banorit, datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992
4. Relacion shpjegues.
5. Deklarata noteriale e kufitarëve.
6. Statusi juridik i pronës ardhur nga ZVRPP Tiranë.

7. Kërkesa e pronarit me prokurë për regjistrim drejtuar Njësisë Administrative Farkë.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit i përcjell në emër të z. **V. SH** të depozituar në Bashki, bazuar në AMTP-në, rezulton se shtetasi ka përfituar një sipërfaqe totale prej 30 100 $m^2$ tokë bujqësore në Fshatin Mjull-Bathore.
Bazuar në çertifikatën e gjendjes civile të përfituesit (kryefamiljarit) datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992, rezulton së në përbërjen e certifikatës familjare janë me 7 (shtatë) anëtarë. Bazuar në shkresën nr 1581 prot., datë 02.05 2019 të Njësisë Administrative Farkë, është përcaktuar norma për frymë për çdo fshatë ku për Fshatin Mjull-Bathore norma për frymë është 2 dynym tokë bujqësore, çfarë do të thotë se familja bujqësore e përfaqësuar ngaz. V. SH ka përfituar 16100 $m^2$ më shumë se sa është përcaktuar norma për frymë në Fshatin Mjull-Bathore, në këto kushte AMTP-ja pa nr. Akti, pa datë dhe pa vit, është pjesërisht e pa vlefshme, çfarë do të thotë se veprimet e ish-komisionit të ndarjes së tokës të fshatit Mjull-Bathore janë në kundërshtim me ligjin nr.7501 datë 19.8.1991 "Për tokën", me VKM nr.255, datë 2.8.1991 "Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore" dhe me ligjin nr. 8053, datë 21.12.1995, "Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore", të ndryshuar.
Me këtë konstatim ka dal edhe komisioni vendor i verifikimit të titujve të pronësisë pranë Prefekturës Tiranë ku me vendim nr.2 datë 31.01.2017 është shfuqizuar pjesërisht AMTP-ja pa nr. Akti, pa datë dhe pa vit në emër të z.V. SH.
Shfuqizimi pjesërisht AMTP-së për sipërfaqen 16100 $m^2$ është lënë fuqi me vendimin nr.1427 datë 07.04.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, i lënë në fuqi me datë 16.05.2017 nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë.
Në Relacioni shpjegues i konspektuar nga specialisti ZMMT-së, K. Kokoli i miratuar nga Përgjegjësi i Sektorit Shërbimeve Publike A. Q dhe i konfirmuar nga Administratori i Njësisë Administrative Farkë z. A. T, në lidhje me AMTP në pronësi të z. V. SH në pikën 2 citohet se AMTP është shfuqizuar pjesërisht nga KVVTP-së Qarku Tiranë duke kthyer në pronësi "shtet" sipërfaqen prej 13100 $m^2$ dhe në pikën 3 të relacionit citohet se me vendimin nr.1427 datë 07.04.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është lënë në fuqi vendimi KVVTP-së Qarku Tiranë, ky konstatim nuk qëndron për faktin se kalimi në pronësi "shtet" nuk është sipërfaqja 13100 $m^2$ por është një sipërfaqe prej 16100 $m^2$.

**<u>Konkluzion</u>:**
-Mungon statusi juridik i pronës e konfirmuar nga DV ASHK Rurale 1, për pasurinë 405/20 me sipërfaqe 6400 $m^2$ në emër të V. SH.
Pasuria 585/20 me sipërfaqe 6400 $m^2$ në emër të V. SH krijon mbivendosje fiktive me pasurinë nr. 405/7, në pronësi të të tretëve.
-Është pranuar kërkesa nga Njësia Administrative Farkë për vazhdimin e procedurës së regjistrimit të pronës në emër të trashëgimtarëve të familjes Shaba pa pasur të administruar në dosje një akt ekspertizë për pasuritë e shfuqizuara me vendim gjykate, çfarë do të thotë se mungon sipërfaqja dhe pozicionimi i përcaktuar në dokumentacionin hartografik të vendimit gjyqësor.

**10.Me shkresën nr.3637/1 prot., datë 26.11.2019** është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në pa nr. akti, datë 5.10.1996, për **R. SH,** drejtuar Drejtorisë të Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, Bashkia Tiranë, dokumentacioni si vijon:
1. Akti i marrjes së tokës në pronësi.
2. Plan rilevimi i pasurisë nr. 497/34 dhe 497/33 shk. 1:2500, datë 08.08.2018.
3. Çertifikatë e gjendjes civile të banorit, datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992
4. Relacion shpjegues.
5. Deklarata noteriale e kufitarëve.
6. Dëshmia e trashëgimisë (fotokopje)
7. Statusi juridik i pronës ardhur nga ZVRPP Tiranë.
8. Kërkesa e pronarit me prokurë për regjistrim drejtuar Njësisë Administrative Farkë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit i përcjell në emër të z. **R. SH** të depozituar në Bashki, bazuar në AMTP-në, rezulton se shtetasi ka përfituar një sipërfaqe totale prej 4000 $m^2$ tokë bujqësore në llojin e pasurisë “arë”,
Referuar statusit juridik të pronës e konfirmuar me shkresën pa nr. prot., datë 31.08.2018 nga ZVRPP Tiranë, rezulton se pasuria nr. 497/34 figuron e regjistruar në vol.5, faqe 183 Z.K. 2529 në llojin e pasurisë “arë” me sipërfaqe prej 4000 $m^2$ në emër të R. SH(i pa pajisur me certifikatë pronësie).
Pasuria nr. 497/34 që figuron e regjistruar me sipërfaqe prej 4000 $m^2$ është ndarë në dy pasuri, njëra më sipërfaqe 3000 $m^2$ në emër tëRamazan Shkalla dhe tjetra 1000 $m^2$në “shtet” bazuar në Plan rilevimin e pasurisë nr. 497/34 shk. 1:2500, datë 08.08.2018.
Ndërsa diferencën tjetër prej 1000 $m^2$ është pozicionuar në një pasuri tjetër që krijojnë mbivendosje me pasurinë nr.497/36 e regjistruar në vol.6, faqe 36, në llojin e pasurisë “arë” me sipërfaqe prej 1100 $m^2$ në emër të I. D dhe me pasurinë nr.497/45 të në vol.7, faqe 97 në llojin e pasurisë “arë” me sipërfaqe prej 2400 $m^2$ në emër të P. SH.

**<u>Konkluzion</u>:**
-Nga Njësia Administrative Farkë është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në pa nr. akti, datë 5.10.1996, për R. SH, duke pranuar plan-rilevimi për ndarje pasurie në dy pasuri, njëra me sipërfaqe 3000 $m^2$ dhe tjetra 1000 $m^2$, në një kohë kur kartela pasuria e përfituar me AMTP ka qenë e hapur me sipërfaqe prej 4000 $m^2$në vol.5, faqe 183, në emër të R. SH.
-Mungon e administruar në dosje deklarata noteriale për pasurinë që krijon mbivendosje me pasurinë nr.497/36 e regjistruar në vol.6, faqe 36, në llojin e pasurisë “arë” me sipërfaqe prej 1100 $m^2$ në emër të I. D dhe me pasurinë nr.497/45 të në vol.7, faqe 97 në llojin e pasurisë “arë” me sipërfaqe prej 2400 $m^2$ në emër të P. SH.
-Mungon e administruar në dosje vërtetimi për shlyerjen e pagesës së taksës së tokës bujqësore.
-Formulari i kërkesës me nr.3637 prot., datë 01.11.2019 drejtuar zyrës së informacionit të Njësisë Administrative Farkë, për vazhdimin e procedurës për regjistrim është plotësuar nga vetë specialisti i kësaj zyre K. F.

**11.Me shkresën nr.993/1 prot., datë 28.03.2019** është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në nr. 134 akti, datë 06.08.1996, për **z. L. H,** drejtuar Drejtorisë të Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, Drejtoria e Pasurive të Paluajtshme, Bashkia Tiranë, dokumentacioni si vijon:
1.Akti i marrjes së tokës në pronësi (fotokopje e njësuar).
2.Plan vendosja e pasurisë nr.51, shk.1:2500, datë 06.03.2019
3.Çertifikatë e gjendjes civile të banori, datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992
4.Statusi juridik i pronës, nga ZVRPP Tiranë.
5.Relacion shpjegues.
6.Kërkesa e pronarit për regjistrim drejtuar Njësisë Administrative Farkë.
Familja bujqësore e përfaqësuar ngaz. L. H, ka përfituar tokë në pronësi me ligjin nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, bazuar ne AMTP nr. 134 akti, datë 06.08.1996 gjithësej 21050 $m^2$, në 3 pasuri të ndryshme në llojin e pasurisë “ullishte”, në fshatin Selitë.
Bazuar në statusin juridik të pronës të dërguar nga ZVRPP Tiranë me datë 07.03.2019 për tre pasuritë të përfituara me AMTP-në rezulton se pasuria 51/106 me sipërfaqe 8250 $m^2$ i cili i përket parcelës me AMTP nr.2 me emërtimin popullor “Parcela 51” kartela është e hapur në vol.19, faqe 216, me datë 12.01.1998 ka mbaruar edhe afishimi publik në emër “shtet” dhe me datë 30.10.2006 ka kaluar në emër L. H, ku më vonë kjo kartelë është mbyllur duke u hapur kartela të tjera me sipërfaqe të ndryshme.
Ndërsa pasuria me sipërfaqe 9800 $m^2$, ku në AMTP figuron në parcelën nr.1 me emërtimin popullor “Parcela 51” nuk rezulton të jetë regjistruar ne ZVRPP Tiranë, këto pasuri ndodhen ne Z.K. 3292.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit i përcjell në emër të L. H rezulton se çertifikata e gjendjes civile të përfituesit (kryefamiljarit) datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992, është me 5 (pesë) anëtarë, ndërsa norma për frymë në Fshatin Selitë ka qenë 3-3.5 dynym tokë bujqësore, çfarë do të thotë se familja bujqësore e përfaqësuar nga L. H ka përfituar 2550 $m^2$ më shumë se sa është përcaktuar norma për frymë në Fshatin Selitë, në këto kushte AMTP-ja pa nr. 134 akti, datë 06.08.1996 është pjesërisht e pa vlefshme.
Nga informacioni i marrë me shkresën nr.8257/1 prot., datë 14.11.2022 nga DV ASHK Rurale 1 rezulton se tre pasuritë e sipërcituara janë refuzuar për regjistrim për faktin se pasuritë krijon mbivendosje fiktive me pasuritë e tjera të regjistruara në emër të shtetasve të tjerë.

**Konkluzion:**
-Është pranuar kërkesa nga Njësia Administrative Farkë për vazhdimin e procedurës së regjistrimit të pronës në emër të z L. H, bazuar në AMTP-në ku rezulton se ka përfituar një sipërfaqe prej 2550 $m^2$ tokën bujqësore më shumë se sa ka qenë norma për frymë në Fshatin Selitë.
-Mungon e administruar në dosje vërtetimi për shlyerjen e pagesës së taksës së tokës bujqësore.

**12.Me shkresën nr.1783/1 prot., datë 30.01.2019** është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në pa nr. Akti, datë 10.10.1996, për **z. Z. P,** drejtuar Drejtorisë të Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, Drejtoria e Pasurive të Paluajtshme, Bashkia Tiranë, dokumentacioni si vijon:
1.Akti i marrjes së tokës në pronësi.
2.Plan vendosja e pasurisë nr.315, shk.1:2500, datë 07.04.2019
3.Çertifikatë e gjendjes civile të banori, datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992
4.Statusi juridik i pronës, nga ZVRPP Tiranë.
5.Relacion shpjegues.
6. Statusi juridik i pronës.
6.Kërkesa e pronarit për regjistrim drejtuar Njësisë Administrative Farkë.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit i përcjell në emër të z. Z. P rezulton se, në relacionin shpjegues të miratuar nga administratori A. T familja bujqësore ka përfituar tokë bujqësore në pronësi sipas ligjit nr.7501 :Për tokën" ku sipas verifikimit të AMTP-së e cila në bazë të VKM-së nr.994, datë 9.12.2015 pika 1 gërma a, b, c dhe ç, është AMTP e rregullt., nga verifikimi në terren të parcelës për të cilën qytetari kërkon ta regjistroj, saktësojmë se parcela me emërtimin popullor "Zall nr.154" me sipërfaqe 4000 m2 me zërin kadastral "arë" në hartën më SH 1:5000 kjo pasuri korrespondon me nr.316 me zërin kadastral "arë" dhe në hartën me SH 1:25000 korrespondon me nr. 315/ me zërin kadastral "arë".
Mbështetur sa sipër Njësia Administrative Farkë ka qenë dakort për regjistrimin e pasurisë në emër të Zydi Plaku dhe pajisjen me certifikatë pronësie.

**Konkluzion:**
-Pasuria ne nr.315/ me sipërfaqe 4000 m2 sipas plan-rilevimit Z.K.1604 mbivendoset mbi parcelën me nr.317 e cila figuron e regjistruar në zërin kadastral "arë" dhe parcelën me nr.318 e cila figuron e regjistruar në zërin kadastral "Pyll" sipas gjendjes 01.08.1991.
-Bashkia Tiranë me shkresën nr.734/3 datë 03.02.2020 e ka kthyer dokumentacionin në Njësinë Administrative Farkë pasi gjatë shqyrtimit ka konstatuar se pasuria bie mbi pasuri "pyll".

**13.Me shkresën nr.705 prot., datë 25.02.2021**, është përcjellë dokumentacioni nga Njësia Administrative Farkë drejtuar DV ASHK Tirana Rurale 1, për verifikim (konfirmim) dhe vendimmarrje në lidhje me kërkesën e **z. F. B,**dokumentacioni si vijon:
1.Akti i marrjes së tokës në pronësi pa nr. Akti datë 14.01.2021 (Dublikatë)
2.Plan vendosja e pasurisë nr.631/, 631/, 631/, 625, shk.1:2500, datë 07.11.2020
3.Çertifikatë e gjendjes civile të banori, datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992

4.Shkresa Bashkisë dhe DV ASHK Tirana Rurale 1.
5.Kërkesa e pronarit për regjistrim drejtuar Njësisë Administrative Farkë.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit i përcjell në emër të z. F. B rezulton se, AMTP-ja (Dublikatë) është plotësuar për një ngastër me kufizimet përkatëse me sipërfaqe 6500 $m^2$ në llojin e pasurisë "arë", kjo AMTP dublikatë është plotësuar duke u mbështetur në AMTP pa nr. Akti dhe pa datë nga ish-komisioni fshatit Lundër.
Plan-rilevimi i përgatitur me datë 07.11.2020 nga Topografi me licencë me sipërfaqe 570 $m^2$ është miratuar nga Kryeplaku i Fshatit dhe nga specialisti ZAMIT-t të Njësisë Administrative Farkë.
Plan-rilevimi i përgatitur me datë 07.11.2020 nga Topografi me licencë me sipërfaqe 720 $m^2$ është miratuar nga Kryeplaku i Fshatit dhe nga specialisti ZAMIT-t të Njësisë Administrative Farkë.
Plan-rilevimi i përgatitur me datë 07.11.2020 nga Topografi me licencë me sipërfaqe 4170 $m^2$ është miratuar nga Kryeplaku i Fshatit dhe nga specialisti ZAMIT-t të Njësisë Administrative Farkë. Plan-rilevimi i përgatitur me datë 07.11.2020 nga Topografi me licencë me sipërfaqe 970 $m^2$ është miratuar nga Kryeplaku i Fshatit dhe nga specialisti ZAMIT-t të Njësisë Administrative Farkë.

**14.Me shkresën nr.1285 prot., datë 16.04.2021**, është përcjellë dokumentacioni nga Njësia Administrative Farkë drejtuar DV ASHK Tirana Rurale 1, për verifikim tekniko-ligjor në lidhje me kërkesën e **z. P. A,** fshati Farkë e Madhe (Z.K. 1604)dokumentacioni si vijon:
1.Akti i marrjes së tokës në pronësi pa nr. 38 Akti datë 03.02.2021 (Dublikatë)
2.Plan vendosja e pasurisë nr.402/16, 280/, 312/, shk.1:2500, datë 03.10.2020
3.Çertifikatë e gjendjes civile të banori, datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992
4.Shkresa Bashkisë dhe DV ASHK Tirana Rurale 1.
5.Kërkesa e pronarit për regjistrim drejtuar Njësisë Administrative Farkë.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit i përcjell në emër të z. P. A rezulton se, AMTP-ja (Dublikatë) është plotësuar për tre ngastra me kufizimet përkatëse me sipërfaqe totale 11400 $m^2$ në llojin e pasurisë "arë" dhe "pemëtore", kjo AMTP dublikatë është plotësuar duke u mbështetur në AMTP pa nr. Akti dhe pa datë nga ish-komisioni fshatit Lundër.

**15.Me shkresën nr.475/1 prot., datë 19.04.2021**, është përcjellë dokumentacioni nga Njësia Administrative Farkë drejtuar DV ASHK Tirana Rurale 1, për verifikim (konfirmim) dhe vendimmarrje në lidhje me kërkesën e **z. Z. A,**dokumentacioni si vijon:
1.Akti i marrjes së tokës në pronësi pa nr. Akti datë 14.01.2021 (Dublikatë)
2.Plan vendosja e pasurisë nr.302/, 300/, shk.1:2500, datë 18.12.2020
3.Çertifikatë e gjendjes civile të banori, datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992
4.Shkresa Bashkisë dhe DV ASHK Tirana Rurale 1.
5.Kërkesa e pronarit për regjistrim drejtuar Njësisë Administrative Farkë.
Nga shqyrtimi i dokumentacionit i përcjell në emër të z. **Z. A** rezulton se, AMTP-ja (Dublikatë) është plotësuar për një ngastër me kufizimet përkatëse me sipërfaqe 11300 $m^2$ në llojin e pasurisë "arë", kjo AMTP dublikatë është plotësuar duke u mbështetur në AMTP pa nr. Akti dhe pa datë nga ish-komisioni fshatit Lundër, në kundërshtim me piken 21.2 VKM nr.1174, datë 24.12.2020 "Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyes".

*VKM nr.1174, datë 24.12.2020 "Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyes".*
*Kreu III. "Regjistrimi i AMTP-ve me mangësi në elementet e formë".*
*Pika 21.2 Drejtoria vendore e ASHK-së, pas hetimit administrativ dhe verifikimit të dokumentacionit të ndarjes së tokës dhe kritereve të regjistrimit, nëse nuk gjendet kopja origjinale e AMTP-së, por provohet që subjekti ka marrë tokë në pronësi, lëshon dublikatë të*

*AMTP-së dhe regjistron pronësinë në bazë të saj, duke pajisur subjektin me një kopje të dublikatës dhe me certifikatën e pronësisë.*

-Plan-rilevimi i përgatitur me datë 07.11.2020 nga Topografi me licencë i miratuar nga Kryeplaku i Fshatit dhe nga specialisti ZAMIT-t të Njësisë Administrative Farkë, nuk përmbushin standardet teknike të përcaktuara në aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në RSH", në kundërshtim me VKM nr. 782, datë 7.10.2020 "Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale",në kundërshtim me piken 13 të VKM nr. 782, datë 7.10.2020 "Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale"**.**

*VKM nr. 782, datë 7.10.2020 "Për miratimin e modeleve të akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale".*
*III. "Harta kadastrale dhe modeli i planit të rilevimit".*
*Pika 13. Plani i rilevimit për punime kadastrale, i hartuar nga eksperti gjeodet i licencuar, i nënshtrohet kontrollit dhe konfirmimit nga ASHK-ja, për standardet teknike.*

**Konkluzion:**
Nga Administratori i Njësisë Administrative Farkë është plotësuar AMTP "Dublikatë" mbas hyrjes në fuqi të ligjit nr.20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH", në tejkalim të kompetencave që i jep ligji organik, ku në bazë të nenit 109, të Ligjit nr. 44/2015 "Për Kodin e Procedurës Administrative" miratimi AMTP "Dublikatë" është një akt administrativ i paligjshëm, ku paligjshmëria është rezultat i nxjerrjes së aktit në kundërshtim me ligjin.

Për sa është trajtuar, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresen nr. 858/3prot., datë 3.5.2023 dhe i administruar në KLSH me nr. 796/15 prot,datë 8,5,2023, "Mbi Projekt-Raportin e Auditimit" dërguar nga z. A. T me detyrë, Administrator i Njësisë Administrative Farkë, zj. F. T, me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së ZAMT, z. A. Q me detyrë, Përgjegjës Sektori i Shërbimeve Publike dhe Z. K. K me detyrë, Specialist i ZAMIT-së, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendim i subjektit:**

*Në përgjigje të Projekt Raportit të Auditimit Tematik me nr.796/12prot, datë, 18.04.2023 të administruar në Njësinë Administrative Farke me nr.858/2, datë, 20.04.2023, mbi auditimin e ushtruar në Njësinë Administrative Farkë, në bazë të programit të auditimitnr. 796/1 prot, datë 04.10.2022, paraqesim observacionin rast pas rasti si më poshtë vijon:*

***Për rastin e Z. H**, Ju sqarojmë se nuk është i drejtë konkluzioni i arritur në pikën 1, se Njësia Administrative Farkë ka pranuar kërkesën për vazhdimin e procedurës së regjistrimit të pronës në emër të **z.S. H** bazuar në një AMTP ku rezulton se familja bujqësore ka përfituar një sipërfaqe prej 22000 $m^2$ tokë bujqësore më shumë se sa ka qenë norma për fryme. Familja bujqësore z. S. H ka përfituar tokën në bazë të VKM-së nr.161, dt.08.04.1993 "Për disa shtesa e ndryshime ne VKM-në nr.452, dt.17.10.1992" Për ristrukturimin e Ndërmarrjeve Bujqësore" neni 1, pika 2. Konkretisht, në pikën 1 të VKM 161 nuk llogaritet norma për frymë për familjet që kanë dorëzuar tokën, por marrin aq sa kanë dorëzuar.*

*Nuk qëndron konkluzioni se Njësia Administrative Farkë është miratuar plan-rilevimi për 3 pasuri duke krijuar mbivendosje fiktive me pasuri të tjera të regjistruara në emër të të tretëve, për këtë ju sqarojmë se hartave qe ju jeni referuar janë të viteve 70, të cilat nuk pasqyrojnë faktin se si është prona në terren, pasi sipas verifikimit në terren nga ana jonë dhe planeve të rilevimit pronat në fjalë nuk krijojnë mbivendosje, pasi është ASHK-ja organi që administron hartat dhe konstaton në se ka mbivendosje ose jo. Njësia Administrative përcjell pranë ASHK (ish ZVRPP) dokumentacionin ligjor dhe Teknik në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe*

*është ASHK ajo që konstaton nëse ka mbivendosje apo jo dhe më pas bën regjistrimin ose refuzimin e kërkesës për regjistrim në përputhje me nenin 26 të ligjit 111/2018 "Për Kadastrën":*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit**

Në lidhje me komentet dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i audituar, sqarojmë se në formularin e AMTP-së e plotësuar nga ish-komisioni i tokës nuk ka shënimin lartë "Trajtuar me VKM nr.161", që do të thotë se nga grupi i auditimit ka qenë e pa mundur identifikimi i trajtimit të familjes bujqësore meVKM-në nr.452, dt.17.10.1992" Për ristrukturimin e Ndërmarrjeve Bujqësore" apo me VKM-së nr.161, dt.08.04.1993.

Në lidhje me komentet dhe shpjegimet e paraqitura nga subjekti i audituar, sqarojmë sepikërisht ASHK-ja që është organi që administron hartat dhe konstaton në se ka mbivendosje ose jo, ka vendosur që plan rilevimet e përgatitura nga topografik me liçencë dhe e miratuara nga Specialisti i ZAMIT-së Njësia Administrative Farkë të mos regjistrohen se nuk përputhen me hartat kadastrale, që do të thotë se kanë krijuar mbivendosje me disa pasuri të tjera të regjistruara.

Për sa më sipër observacioni në lidhje me komentin e paraqitur **nuk merret në konsideratë**.

**Pretendim i subjektit:**

*Për rastin e Z. B nga ana juaj është arritur në konkluzion se "Është pranuar kërkesa nga Njësia Administrative Farkë për vazhdimin e procedurës së regjistrimit të pronës në emër të z. N. B, bazuar në një AMTP ku rezulton se ka përfituar një sipërfaqe prej 7710 $m^2$ tokën bujqësore më shumë se sa ka norma për frymë në Fshatin Mjull-Bathore. për këtë ju sqarojmë se referuar akteve ligjore në fuqi në asnjë pikë të VKM-së nr. 994, datë 09/12/2015 të Këshillit të Ministrave" i ndryshuar me VKM-në nr.299, dt.10.05.2019, nuk përmendet norma për frymë gjithashtu ju bëjmë me dije se Njësia Administrative Farke nuk ka tagër ligjore që të ndërhyjë apo të ndryshoje një AMTP, qoftë kjo dhe për normën për frymë, pasi dhe në bazë të ligjit nr.139/2015 ''Për vetëqeverisjen vendore'', neni 66, pika a) dhe c), Njësia Administrative është zyrë shërbimi për të gjitha procedurat administrative të Bashkisë si dhe dërgon dokumentacionin pranë strukturave kompetente të Bashkisë.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit**

Akti i marrjes së tokës në pronësi, i fituar përpara hyrjes në fuqi të ligjit 20/20 i paregjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, nuk i nënshtrohet verifikimit të vlefshmërisë nga ASHK-ja, që do të thotë se përfituesi i AMTP-së nuk ka qenë i legjitimuar për të përfituar tokë bujqësore më shumë se sa ka norma për frymë në Fshatin Mjull-Bathore.

Për sa më sipër observacioni në lidhje me komentin e paraqitur **nuk merret në konsideratë**.

**Pretendim i subjektit:**

*Për rastin e Z. B nga ana juaj është arritur në konkluzion se "Janë miratuar nga Njësia Administrative Farkë dy plan-rilevime duke mos u përputhë me gjendjen faktike në terren.*

*Është miratuar plan-rilevimi i miratuara nga Njësia Administrative Farkë për pasurinë me nr.257/11/1 me sipërfaqe 550 $m^2$ e përfituar me AMTP mbi pasurinë P.F"*

*Ky konstatim nuk qëndron pasi nuk është përgjegjësia e Njësisë Administrative për aktet administrative të nxjerra nga komisioni i ndarjes së tokës në vitin 1992.*

*Për rastin e Z. XH nga ana juaj është arritur në konkluzion se "-Është miratuar nga Njësia Administrative Farkë plan-rilevimi për parcelën e renditur në AMTP me emrin "Topore" me sipërfaqe 2000 $m^2$ mbi pasurinë nr.608 të zërit kadastral P.F. -Mungon e administruar në dosje vërtetimi për shlyerjen e pagesës së taksës së tokës bujqësore".*

*Për rastin e Z. K nga ana juaj është arritur në konkluzion se " Në dosje nuk është administruar deklarata noteriale Bp. D. për heqjen dorë mbi pasurinë 664/24 që*

*figuron e regjistruar në vol.8, faqe 78 Z.K. 2529 në llojin e pasurisë "arë" me sipërfaqe prej 3750 m$^2$. Nga Njësia Administrative Farkë është pranuar kërkesa për vazhdimin e procedurës së regjistrimit të pronës të trashëgimtarëve të familjesKodra pa pasur një prokurë të posaçëm të trashëgimtarëve ligjorë për z. A. Ç, në lidhje me veprimet ligjore që do të kryen në Njësia Administrative Farkë dhe në ZVRPP Tiranë, çfarë do të thotë se personi nuk është i legjitimuar për paraqitjen e kërkesë për vazhdimin e procedurës së regjistrimit të pronës".*

*Konstatimi juaj nuk qëndron, pasi siç e kemi shpjeguar dhe më parë, nuk është përgjegjësia e Njësisë Administrative për aktet administrative të nxjerra nga komisioni i ndarjes së tokës në vitin 1992.*

**<u>Qëndrimi i Grupit të auditimit</u>**

Në asnjë rast grupi i auditimit nuk ka bërë me përgjegjësi Njësinë Administrative për aktet administrative të nxjerra nga ish-komisioni i ndarjes së tokës të vitit 1992, e në vazhdim. por në të gjitha rastet përgjegjësia bie mbi ish-komisionin e ndarjes së tokës për të cilin ka plotësuar AMTP-të në kundërshtim me VKM nr. 230, datë 22.7.1991, të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e komisioneve të tokave", të ndryshuar dhe në udhëzimin nr.2, datë 2.8.1991, të Këshillit të Ministrave "Për funksionimin e komisioneve të tokës në rrethe e fshatra".

Për sa më sipër observacioni në lidhje me komentin e paraqitur **merret në konsideratë** pjesa e mos përgjegjësisë të Njësisë Administrative Farke në lidhje me plotësimin e AMTP-ve.

**<u>Pretendim i subjektit:</u>**

*Për rastin e Z. B. S nga ana juaj është arritur në konkluzion se "Sipërfaqja e përfituar me AMTP prej 1900 m$^2$ si tokë bujqësore në llojin e pasurisë "arë" ndodhet brenda vijës së verdhë të qytetit, çfarë do të thotë se pasuria është tokë "truall" për rrjedhojë ish-komisioni i ndarjes së tokës fshati Shkozë ka vepruar në kundërshtim me VKM Nr. 452, date 17.10.1992 "Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore", në këto kushte qytetari nuk ka qenë i legjitimuar për të përfituar tokë sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore. Në lidhje me konstatimin tuaj se pasuria është truall jo informojmë se AMTP e këtij shtetasi është dhënë nga komisioni i ndarjes së tokës në përputhje me ligjin 7501.*

*Parcela me AMTP-ne nr. 76 me emërtimin popullor "Mocka" mc sip. 1000 m2 me zërin kadastral "Are" ne hartën e shk. 1:5000 kjo pasuri korrespondon mc nr. 76 me zërin kadastral "Are" dhe ne hartën e shk. 1:2500. korrespondon mc nr. 10/67 me zërin kadastral "Are", nga verifikimi ne terren, kjo parcele ka nje siperfaqeprej 1000 m2.dhc mbi këtë parcele ka dhe një objekt qe është në proces legalizimi gjithashtu kjo zonë sot është pjesë e Njësia Administrative nr.2 pra zona kadastralenr.8170. kjo e pasqyruar edhe ne planin e rilevimit date 04/02/2013 per këtë parcele ne emër Z. B. S.*

*Sa më sipër, në kushtet kur është dhënë AMTP kjo pasuri ka qenë tokë bujqësore është përcjell për regjistrim AMTP në përputhje me VKM 994/2015.*

**<u>Qëndrimi i Grupit të auditimit</u>**

Nga DV ASHK Tirana Rurale 1, nuk është bërë regjistrimi i pasurive bazuar në AMTP pikërisht se sipërfaqja e përfituar me AMTP si tokë bujqësore në llojin e pasurisë "arë" ndodhet brenda vijës së verdhë të qytetit, çfarë do të thotë se pasuria është tokë "truall" për rrjedhojë ish-komisioni i ndarjes së tokës fshati Shkozë ka vepruar në kundërshtim me VKM Nr. 452, date 17.10.1992 "Per ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore", në këto kushte qytetari nuk ka qenë i legjitimuar për të përfituar tokë sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore.

Për sa më sipër observacioni në lidhje me komentin e paraqitur **nuk merret në konsideratë**.

**<u>Pretendim i subjektit:</u>**

*Për rastin e Z. H nga ana juaj është arritur në konkluzion se "Nga ana e Njësisë Administrative Farkë është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në nr. 162 akti, viti 1996, për H. H, pa pasur më parë një deklaratë noteriaie*

*të shtetasit D. P në lidhje me pasurinë nr. 182/5 që figuron e regjistruar në vol.1, faqe 139 Z.K. 1605 në llojin e pasurisë "vreshtë" me sipërfaqe prej 2362 $m^2$ në emër të D. P, që krijon mbivendosje pasurie. Nga ana jonë është përcjell dokumentacioni në përputhje me ligjin, dhe është detyrë e ASHK për të kërkuar deklaratë noteriale nga personat që është regjistruar kjo pasuri. Titulli i pronësisë nuk i është shfuqizuar kësaj familje dhe nëse nuk plotësohen kushtet për regjistrim ASHK bën refuzimin e kërkesës në përputhje me nenin 26 të ligjit 111/2018. Pra, pasuritë mund të krijojnë mbivendosje fiktive, por nuk është njësia administrative organi që zgjidh mbivendosjet. Njësia administrative dërgon dokumentacion për kompetencë dhe vendimmarrje në institucione të tjera.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit**

Referuar statusit juridik të pronës pasuria nr. 182/5 figuron e regjistruar në vol.1, faqe 139 Z.K. 1605 në llojin e pasurisë "vreshtë" me sipërfaqe prej 2362 $m^2$ në emër të D. P (i pa pajisur me certifikatë pronësie), mbi këtë pasuri është përgatitur edhe plan-rilevimi duke krijuar mbivendosje me pasurinë e përfituar nga D. Pm, çfarë do të thotë se "...problemet e keqpozicionimit të titullit dhe kufijve të tij zgjidhen duke u mbështetur në gjendjen e pasurisë së poseduar faktikisht në terren, për aq sa ajo nuk bie ndesh me tituj të tjerë pronësie private".
Për sa më sipër observacioni në lidhje me komentin e paraqitur **nuk merret në konsideratë**.

**Pretendim i subjektit:**

*Për rastin e Z. SH nga ana juaj është arritur në konkluzion se "Nga Njësia Administrative Farkë është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në' AMTP-në pa nr. akti, datë 5.10.1996, për R. SH, duke pranuar plan-rilevimi për ndarje pasurie në dy pasuri, njëra me sipërfaqe 3000 $m^2$ dhe tjetra 1000 $m^2$, në një kohë kur kartela pasuria e përfituar me AMTP ka qenë e hapur me sipërfaqe prej 4000 $m^2$ në vol.5, faqe 183, në emër të R. SH.E kundërshtoj gjetjen tuaj edhe në këtë rast, pasi me hyrjen në fuqi të ligjit 2020, në prill të vitit 2020 të gjitha dosjet i kalonin për kompetencë dhe vendimmarrje ASHK. Kjo dosje është përcjell në muajin nëntor të vitit 2020, kur në fuqi ka qenë ligji 2020.*

**Qëndrimi i Grupit të auditimit**

Në radhë të parë nuk ka arsye që në observacion të citohen të gjithë nenet e ligjit nr. 20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në RSH" për sa kohë ky ligj ka hyrë në fuqi mbasi i gjithë dokumentacioni është dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit, Bashkia Tiranëme shkresën nr.3637/1 prot., datë 26.11.2019 që do të thotë se praktika është dërguar para daljes së ligjit 20/20.
Në radhe të dytë bazuar në AMTP-në, si dhe referuar statusit juridik të pronës e konfirmuar me shkresën pa nr. prot., datë 31.08.2018 nga ZVRPP Tiranë, rezulton se pasuria nr. 497/34 figuron e regjistruar në vol.5, faqe 183 Z.K. 2529 në llojin e pasurisë "arë" me sipërfaqe 4000 $m^2$ në emër të R. SH(i pa pajisur me certifikatë pronësie) dhe nuk ka pse sip.1000 $m^2$ të pozicionohet në një pasuri tjetër që krijojnë mbivendosje me pasurinë nr.497/36 e regjistruar në vol.6, faqe 36, në llojin e pasurisë "arë" me sipërfaqe prej 1100 $m^2$ në emër të I. D dhe me pasurinë nr.497/45 të në vol.7, faqe 97 në llojin e pasurisë "arë" me sipërfaqe prej 2400 $m^2$ në emër të P. SH.
Për sa më sipër nenet e ligjit 20/20 të paraqitura si dhe komentin **nuk merret në konsideratë**.

## IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi: Në 3 raste** nga Administratori i Njësisë Administrative Farkë është dërguar AMTP-së "***Dublikatë***" nëpërmjet Sektorit të AMTP-së pranë Bashkisë Tiranë, *konkretisht*:

- Dokumentacionit i përcjell në emër të **z. F. B**, AMTP-ja (Dublikatë) është plotësuar duke u mbështetur në AMTP pa nr. Akti dhe pa datë nga ish-komisioni i fshatit Lundër
- Dokumentacionit i përcjell në emër të **z. P. A**, AMTP-ja (Dublikatë) është plotësuar duke u mbështetur në AMTP pa nr. Akti dhe pa datë nga ish-komisioni fshatit Lundër.
- Dokumentacionit i përcjell në emër të z. **Z. A**, AMTP-ja (Dublikatë) është plotësuar duke u mbështetur në AMTP pa nr. Akti dhe pa datë nga ish-komisioni fshatit Lundër, në kundërshtim me piken 21.2 VKM nr.1174, datë 24.12.2020 "Për procedurat e regjistrimit të AMTP-ve, saktësimin e kufijve e sipërfaqeve, si dhe normat për sipërfaqet shtetërore shtesë e pronat shërbyes" *(Më hollësisht janë trajtuar në faqen 9-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:**Në gjitha rastet për kryerjen e procedurave që lidhen me krijimin e titujve të pronësisë të rinjë mbi tokën bujqësore, kur AMTP-ja do të plotësohet "Dublikatë", Njësia Administrative Farkë duhet të dërgoj AMTP-në për verifikim dhe miratim në Sektorin e AMTP-së pranë Bashkisë Tiranë.

**Në vijimësi**

**2. Gjetje nga auditimi:** Në 3 raste nga Njësia Administrative Farkë është përcjellë për në DV ASHK Tirana Rurale 1, plani i rilevimit i hartuar nga eksperti gjeodet i licencuar, i cili nuk përmbushë standardet teknike të përcaktuara në aktet nënligjore të dala në zbatim të ligjit nr. 72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në RSH *(Më hollësisht janë trajtuar në faqen 9-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandimi:**Njësia Administrative Farkë të përcjellë për në DV ASHK Tirana Rurale 1, plan rilevimit të hartuar nga eksperti gjeodet i licencuar, duke përmbushur standardet teknike të përcaktuara dhe në modelet e akteve kadastrale dhe të dhënave në përmbajtje të hartës kadastrale.

**Në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi**: **Në 3 raste**, nga ish-komisioni i ndarjes së tokës në fshatë janë pajisur familjet bujqësore me tokë bujqësore më shumë se sa është përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Komunës, duke tejkaluar normën për frymë, në kundërshtim me ish-ligjin nr, 7501, datë 19.7.1991 "Për tokën" dhe me ligjit 20/2020 dhe ligjin nr.111/2018 "Për Kadastrën" *(Më hollësisht janë trajtuar në faqen 9-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1. Rekomandimi:** Nga Njësia Administrative Farkë në të gjitha raste para se të përcjellje dokumentacionin për në DV ASHK Rurale 1, të verifikojë normën për frymë, bazuar në certifikatën familjare datë 01.8.1991 dhe datë 01.10.1992.

**Në vijimësi**

**4. Gjetje nga auditimi:**Nga Njësia Administrative Farkë është pranuar kërkesa për vazhdimin e procedurës së regjistrimit të pronës të trashëgimtarëve të familjes Kodra pa pasur një prokurë të posaçëme të trashëgimtarëve ligjorë për z. A. Ç, në lidhje me veprimet ligjore që do të kryhen në Njësia Administrative Farkë dhe në ZVRPP Tiranë, çfarë do të thotë se personi nuk është i legjitimuar për paraqitjen e kërkesë për vazhdimin e procedurës së regjistrimit të pronës *(Më hollësisht janë trajtuar në faqen 9-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1. Rekomandimi:**Nga Njësia Administrative Farkë mos të pranohen kërkesa për vazhdimin e procedurës së regjistrimit të pronës jashtë rrethit familjar të përfituesit të tokës bujqësore, ose pa pasur një prokurë të posaçme të trashëgimtarëve ligjor**.**

**Në vijimësi**

**5. Gjetje nga auditimi:** Sipërfaqja e përfituar me AMTP prej 1900 m$^2$ si tokë bujqësore në llojin e pasurisë "arë" ndodhet brenda vijës së verdhë të qytetit, çfarë do të thotë se pasuria është tokë "truall" e për rrjedhojë ish-komisioni i ndarjes së tokës ne fshatin Shkozë ka vepruar

në kundërshtim me VKM Nr. 452, date 17.10.1992 “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”, në këto kushte qytetari nuk ka qenë i legjitimuar për të përfituar tokë sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore *(Më hollësisht janë trajtuar në faqen 9-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1. Rekomandimi:** Nga Njësia Administrative Farkë në të gjitha rastet para se të përcjellë dokumentacionin për në DV ASHK Rurale 1, të verifikojë nëse kërkuesi ka qenë i legjitimuar për të përfituar tokë sipas akteve ligjore e nënligjore për ndarjen e tokës bujqësore.

**Në vijimësi**

**6. Gjetje nga auditimi:** Në 5 raste, nga specialisti ZAMIT-t të Njësisë Administrative Farkë nuk është verifikuar pasuria në terren, por është referuar plan-rilevimit i përgatitur nga topografi me licencë, ku ky i fundit i është referuar pasurisë sipas hartës kadastrale të DV ASHK Rurale 1, në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 09.12.2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me AMTP, të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën” *(Më hollësisht janë trajtuar në faqen 9-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1. Rekomandimi:** Specialisti i ZMMT-së, pranëNjësisë Administrative Farkë, në të gjitha rastet kur ka kërkesa për saktësim harte, duhet të verifikoj vetë fizikisht bashkë me topografin me licencë, ndryshimet e ndodhura pa ndryshuar kufijtë e pronave të tjera**.**

**Në vijimësi**

**7. Gjetje nga auditimi:** Në 5 raste, formulari i kërkesës që qytetari ka paraqitur pranë zyrës së informacionit të Njësisë Administrative Farkë, për vazhdimin e procedurës për regjistrim është plotësuar nga vetë specialisti i kësaj zyre, në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 09.12.2015 "Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me AMTP, të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe ligji nr. 111/2018 "Për Kadastrën**"** ***(Më hollësisht janë trajtuar në faqen 9-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).***
**7.1. Rekomandimi:**Nëpunësi i zyrës së pritjes pranë Njësisë Administrative Farkë të pranoje kërkesa për vazhdimin e procedurës për regjistrim, të konfirmuar vetëm nga personi kërkues.

**Në vijimësi**

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga ana e Njësisë Administrative Farkë është dërguar dokumentacioni për regjistrim prone bazuar në AMTP-në nr. 162 akti, viti 1996, për H. H, pa pasur më parë një deklaratë noteriale të shtetasit D. P në lidhje me pasurinë nr. 182/5, që figuron e regjistruar në vol.1, faqe 139 Z.K. 1605 në llojin e pasurisë "vreshtë" me sipërfaqe prej 2362 $m^2$ në emër të D. P, që krijon mbivendosje pasurie, në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 09.12.2015 "Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me AMTP, të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe ligji nr. 111/2018 "Për Kadastrën" *(Më hollësisht janë trajtuar në faqen 9-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**8.1. Rekomandimi**: Specialisti i ZMMT-së, pranëNjësisë Administrative Farkë, në të gjitha rastet kur ka kërkesa nga saktësim harte të shoqërohet më deklaratë noteriale me kufitarët e pasurisë që do të saktësohej.

**Në vijimësi**

**9. Gjetje nga auditimi:** Në 5 raste, pasuritë e përfituar me anë të AMTP-së bien mbi pasuri P.F. (tokë e pa frytshme", mbi pasuri "rrugë" dhe mbi pasuri "pyll", në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 09.12.2015 "Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me AMTP, të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore", të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, "Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve", i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" dhe ligji nr. 111/2018 "Për Kadastrën" *(Më hollësisht janë trajtuar në faqen 9-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
**9.1. Rekomandimi:**Njësia Administrative Farkë para se të dërgoj AMTP-së dhe plan rilevimin për regjistrim, duhet që Specialisti i ZAMIT-së. të verifikoj formularin nr.6, librin e ngastrës dhe në hartën kadastrale të shkalles 1:5000 para vitit 1991, për vlefshmërinë e ngastrës për zërin kadastral të pasurisë.

**Në vijimësi**

**10. Gjetje nga auditimi: Në të gjitha rastet**, relacioni shpjegues i administruar në dosje i konspektuar nga specialisti ZMMT-së, i konfirmuar nga Përgjegjësi i Sektorit Shërbimeve Publike dhe i miratuar nga Administratori i Njësisë Administrative, janë pa datë miratimi dhe pa numër protokolli, në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 09.12.2015 "Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me AMTP, të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë

7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën” ***(Më hollësisht janë trajtuar në faqen 9-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit)***.

**10.1. Rekomandimi:** Specialisti i ZMMT-së, pranëNjësisë Administrative Farkë, në të gjitha rastet kur dokumentacioni shoqërohet me Relacion Shpjegues, kjo e fundit të protokollohet pranë zyrës së protokollit

**Në vijimësi**

**11. Gjetje nga auditimi: Në 6 raste,** në dosje mungon e administruar vërtetimi për shlyerjen e pagesës së taksës së tokës bujqësore, në kundërshtim me VKM nr. 994, datë 09.12.2015 “Për mënyrën e procedimit për pasuritë e paluajtshme, të fituara me AMTP, të nenit 9 të Ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar të Ligjit nr. 171/2014, “Për përfundimin e procedurave ligjore të kalimit të tokës bujqësore të ish-ndërmarrjeve bujqësore në pronësi të përfituesve”, i ndryshuar, si dhe të neneve 25 dhe 45 të ligjit 33/2012 datë 21.03.2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe ligji nr. 111/2018 “Për Kadastrën” *(Më hollësisht janë trajtuar në faqen 9-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**11.1. Rekomandimi:** Njësia Administrative Farkë para se të dërgoj AMTP-së, të kërkoje nga poseduesi i tokës bujqësore vërtetimin nga zyra e taksave dhe e tatimeve për shlyerjen e pagesës së taksës së tokës bujqësore.

**Në vijimësi**

## B. MASA DISIPLINORE

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenin 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për të gjithë punonjësit e trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Tiranë**të vlerësojë shkeljet e konstatuara, për fillimin ose jo të procedurave për masë disiplinore, në zbatim të shkronjat (b, c, ç) e nenit 58 “*Llojet e masave disiplinore*” të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, shkronja (b) e nenit 9 “*Masa disiplinore* ”, të kontratës individuale dhe shkronja (k) e nenit 64 të ligjit nr. 139/2015 datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, si dhe të kontratës individuale.

**Menjëherë**

**Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi (Tematik).**

**AUDITUESIT SHTETRORË TË KLSH**

**K. GJ**

**S. S**

**P. GJ**

**DREJTORI I DEPARTAMENTIT**
**B. D**

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**